



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Inputi për Raportin e Progresit

Janar 2012
PRISHTINË

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE.....	5
HYRJE.....	9
1. KRITERET POLITIKE.....	11
1.1. DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT.....	11
1.1.1. Institucionet.....	11
1.1.2. Parlamenti / Zgjedhjet.....	11
1.1.3 Administrata Publike.....	11
1.1.4. Sistemi gjyqësor.....	12
1.1.5. Politikat Kundër Korrupsionit.....	13
1.2. TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE.....	13
1.2.1 Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve.....	13
1.2.2. Të drejtat e minoriteteve, të drejtat kulturore dhe mbrojtja e minoriteteve.....	14
1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE.....	15
2. KRITERET EKONOMIKE.....	17
2.1. FUNKSIONIMI I EKONOMISË SË TREGUT.....	17
2.1.1. Raportimi në lidhje me zhvillimet e fundit ekonomike.....	17
2.1.2. Raporti për politikat monetare dhe fiskale gjatë periudhës raportuese.....	19
2.1.3. Funkcionimi i tregjeve të produkteve.....	21
2.1.4. Sektori financiar.....	22
2.2. KAPACITETI PËR TU PËRBALLUR ME PRESIONIN E KONKURENCËS DHE FORCAVETË TREGUT BRENDA UNIONIT.....	22
2.2.1. Kapitali Njerëzor dhe Fizik.....	22
2.2.2. Reforma dhe liberalizimi i industrive të rrjetit.....	23
2.2.3. Zhvendosjet strukturore në ekonomi.....	24
2.2.4. Intervenimet e Qeverisë në ekonomi.....	25
2.2.5. Integrimi tregtar.....	25
3. STANDARDET EVROPIANE.....	27
3.1. TREGU I BRENHËM.....	27
3.1.1 Lëvizja e Lirë e Mallrave.....	27
3.1.2. Lëvizja e Lirë e Kapitalit.....	28
a. Doganat.....	29
b. Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).....	29
3.1.4. Konkurrenca.....	29
3.1.5. Prokurimi Publik.....	29
3.1.6. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale dhe të Drejtat e Autorit.....	30
3.1.7. Punësimi dhe Politikat Sociale.....	31
3.1.8. Arsimi dhe Huluntimi.....	31
3.2. POLITIKAT SEKTORIALE.....	34
3.2.1. Industria dhe NVM-të.....	34
3.2.3 Mjedisi.....	34
3.2.4. Politikat e Transportit.....	34
3.2.5. Energjia.....	35
3.2.7. Kontrolli Financiar.....	36
3.2.8. Statistikat.....	37
3.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA.....	37
3.3.1. Vizat, kufijtë, azili dhe migrimi.....	37
3.3.2. Pastrimi i Parave.....	37
3.3.3. Policia dhe Luftimi i Krimin të Organizuar.....	37
3.3.4. Mbrojtja e të dhënave personale.....	38
ANEKSI I - LIGJET E MIRATUARA NGA QEVERIA DHE KUVENDI.....	39
5. ANEKSI II: TABELAT.....	45

TABELAT

Tabela 1 - BPV nominale dhe reale sipas shpenzimeve.....	18
Tabela 1: Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm, në miliona euro dhe si % në GDP.....	45
Grafiku : Ndryshimi vjetor në ICK dhe në ICK bazë (Core Inflation).....	45
Tabela 2: Te hyrat dhe shpenzimet buxhetore te nivelit komunal dhe qendror Janar- Nëntor, 2011.....	45
Tabela 3: Shpërndarja e FDI nëpër sektorë, si përqindje në total FDI.....	46
Tabela 4: Indikatorët e sektorit bankar.....	46
Tabela 5: Të dhënat për eksport-import.....	47
Tabela 6: Pjesëmarrja e FDI në GDP dhe vlera kumulative e FDI nga viti 2004.....	47

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

AAP	Arsimi dhe Aftësimi Profesional
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
AGPK	Asociacioni i Gazetarëve të Pavarur të Kosovës
AKB	Aleanca Kosovare e Bizneseve
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
AKK	Autoriteti i Kualifikimeve Kombëtare
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKS	Agjencia Kosovare për Standarde
AMPM	Antemortum – Postmortum
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
ANVM	Agjencioni për Ndërrmarjet e Vogla dhe të Mesme
APIK	Agjencioni për Promovimin e Investimeve në Kosovë
APK	Agjencioni Pyjor i Kosovës
APP	Agjencia për Prokurim Publik
ARBK	Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
ART	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (<i>Central European Free Trade Agreement</i>)
DAK	Drejtoria e Akreditimit të Kosovës
DASHC	Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil
DBJN	Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar
DK	Doganat e Kosovës
DMNV	Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave
DMRAP	Departamenti për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike
DPI	Departamenti i Pronësisë Intelektuale
ECAA	Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit (<i>European Common Aviation Area</i>)
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
FADN	Rrjeti i te Dhënave për Kontabilitetin e Fermave (<i>Farm Accountancy Data Network</i>)
FET	Fondacioni European për Trajnime
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GDDS	General Data Dissemination Standard
GND	Grupi Ndërmintor për Decentralizim
GP	Grupi Punues
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IFS	Institucionet Ndërkombëtare Financiare
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës
IHH	Indeksi Herfindalh - Hirschman
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IOM	Organizata ndërkombëtare e Migrimit (<i>International Organization for Migration</i>)
IPA	Instrumenti për asistencë të Para Anëtarësimit
IPN	Instituti për Produktet e Ndërtimit
KE	Komisioni Evropian
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KK	Kuvendi/et Komunal/e
KKDFE	Kompania Kosovare e Distributimit dhe Furnizimit me Energji Elektrike

KKK	Korniza e Kurrikulumi të Kosovës
KNRAP	Komiteti Ndërmintor për Reformën e Administratës Publike
KOSTT	Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës
KPGJP	Komisioni i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial
KPGjP	Këshilli i Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial
KPK	Komisioni Prokurorial i Kosoves
KPMM	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve
KQP	Komisioni Qeveritar për Privatizim
KQPZh	Komisioni Qendror për Persona të Zhdukur
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
MAP	Ministria e Administratës Publike
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZhR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEK	Menaxhimi i Financave të Kontrollit
MF	Ministria e Financave
MFSK	Ministria e Forcës dhe Sigurisë
MI	Ministria e Infrastrukturës
MIE	Ministria e Integritetit Evropian
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
ML	Ministritë e Linjës
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPF	Monitorimi i Punës së Fëmijëve
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZhe	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NjDNJK	Njësia për të Drejtat e Njeriut të Komunave
NjIF	Njësia e Inteligjencës FinanciareB Ndërmarrje Publike
NSH	Ndërmarrje Shoqërore
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OEAK	Oda Ekonomik Amerikane e Kosovës
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
OJQ	Organizatata Jo-Qeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PFAL	Programi Fillestar për Arsimim Ligjor
PK	Policia e Kosovës
PKK	Pika e Kalimit Kufitar
Projekti RAE	Projekti për Romët, Ashkalitë dhe Egjiptasit
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
PSH	Prokuroria e Shtetit
PSO	Procedurat Standarde të Operimit
PTB	Projekti Tam/Bas
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
PVAL	Programi i Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
PVPQ	Plani Vjetor i Punës së Qeverisë së Kosovës
PZhBV	Personat e Zhvendosur Brenda Vendit
QAP	Qendra për Aftësim Profesional

RAP	Reforma e Administratës Publike
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SEECCL	South East European Center for Entrepreneurial Learning
SEMSF	Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik
ShKCAK	Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
ShKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës
ShPK	Shërbimi Policor i Kosovës
SISH	Sistemi Informimin Shëndetësor
SKQZ	Sekretariati i Komisionit Qendror i Zgjedhjeve
SMC	Sistemi i Monitorimit të Cilësisë
SMIL	Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve
SMP	Staff Monitored Program
SPVKK	Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër-Korrupsion
TAIEX	Asistencë teknike dhe shkëmbim informacioni (<i>Technical Assistance and Information Exchange</i>)
TVK	Trupa e Vlerësimit për Standarde
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UA	Udhëzim Administrativ
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (<i>United Nations Development Programme</i>)
UNHCR	Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (<i>Office of the United Nations High Commissioner for Refugees</i>)
USAID	United States Agency for International Development
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZÇK	Zyra për çështje të komuniteteve
ZKK	Zyra për Kthim dhe Komunitete
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZPI	Zyra për Pronësi Industriale
ZQM	Zyra për Qeverisje të Mirë
ZRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë
ZRRUM	Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina

HYRJE

Ky raport përmban zhvillimet kryesore në Kosovë nga 1 shtatori 2011 deri në 31 dhjetor 2011, përkatësisht përfshinë kuartalin e katërt të vitit 2011. Qeveria e Republikës së Kosovës ka shprehur gatishmërinë e saj për t'i dorëzuar të dhënat shtesë për këtë periudhë tre mujore për Raportin e Progresit të Kosovës për Komisionin Evropian, i cili do të publikohet në vjeshtën e vitit të ardhshëm.

Të dhënat e prezantuara në këtë raport fokusohen në arritjet e bëra karshi:

zbatimit të reformave;

zhvillimin e kapaciteteve legjislativë dhe administrative;

sfidat e identifikuara në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2011, dhe

Zbatimin e prioritetëve të Partneritetit Evropian, përmes Planit të Veprimit për Partneritet Evropian;

Struktura e të dhënave korrespondon me Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2011 duke ofruar informata mbi tri fushat në vijim: Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike dhe Standardet Evropiane. Raporti gjithashtu është i bazuar në raporte periodike (tre mujorësh) të hartuara nga institucionet e Republikës së Kosovës.

1. KRITERET POLITIKE

1.1. DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT

1.1.1. INSTITUCIONET

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka shqyrtuar 8 raporte të institucioneve të pavarura, si dhe ka hartuar raporte mbi monitorimin e 8 ligjeve të cilat më pas janë miratuar nga komisionet funksionale. Për ngritjen e kapaciteteve të Kuvendit janë mbajtur 7 trajnime për 114 zyrtarë. Fushat e trajnimit ishin: hartimi i legjisllacionit, ligji i ri i shërbimit civil dhe aktet nënligjore, ligji i pagave të nëpunësive civil, praktikat e bazuara në praktikat rregulluese të Bashkimit Evropian (BE), standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut, menaxhimi i dokumenteve në letër dhe formë elektronike.

Me 21 dhjetor 2011, Qeveria ka aprovuar Planin e Veprimit për Partneritet Evropian 2012, kurse në mbledhjen e datës 05.01.2012 ka miratuar Planin Vjetor të Punës së Qeverisë (PVPQ) për vitin 2012 (duke përfshirë edhe programin legjisllativ si dhe planin e dokumenteve strategjike si aneks). Me 1 shkurt 2011, Qeveria ka miratuar strukturën e Komiteteve Ekzekutive për Integrim Evropian.

Sa i përket fushës së decentralizimit është bërë plotësim ndryshimi i Udhëzimit Administrativ 2011/1 (UA) për Themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në Komuna, është hartuar Udhëzuesi për ngritjen e cilësisë së akteve komunale, është hartuar Model Rregullorja për Komitete Konsultative, si dhe është hartuar Model Rregullorja për bashkëpunimin e komunës me fshatrat dhe lagjet urbane.

Sistemi i bazuar në indikatorë për vlerësimin e performancës së komunave është zhvilluar në të gjitha komunat, me përjashtim të tri komunave në veri të vendit. Gjatë vitit 2011 është bërë rishikimi i indikatorëve matës në sistemin e instaluar. Nga gjithsejtë 232 indikatorë sa ishin të vendosur në këtë sistem, në bashkëpunim me komunat dhe USAID-in, tani janë të vendosur 126 indikatorë.

1.1.2. PARLAMENTI / ZGJEDHJET

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) pas analizimit të proceseve zgjedhore të kaluara ka hartuar rekomandime lidhur me amandamentimin e Ligjit për Zgjedhjet të cilat ju kanë dërguar Grupit Punues për Reformën Zgjedhore.

Gjatë periudhës raportuese janë trajnuar gjithsej 15 zyrtarë të SKQZ-së, në temat "Regjistrimi i votueseve dhe krijimi i Listës Votuese", si dhe "Menaxhimi Zyrtar në Institucione".

1.1.3 ADMINISTRATA PUBLIKE

Në përpjekje për avancimin e reformës së administratës publike, Komisioni Ndërmintor për Reformën e Administratës Publike (KNRAP) në takimin e datës 23.11.2011 ka miratuar Planet Zhvillimore Strategjike për Zyrën e Kryeministrit (ZKM), Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministrinë e Drejtësisë (MD) dhe Ministrinë e Kulturës, të Rinisë dhe të Sporteve (MKRS). KNRAP në këtë takim mori vendim që Departamenti për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike (DMRAP) të bëjë monitorimin e të gjitha Planeve Zhvillimore Strategjike, dhe u vendos që në këtë detyrë Ministria e Integritimit Evropian (MIE) ta ndihmojë DMRAP me një përfaqësues të saj. Për më tepër është miratuar propozimi për ndryshimin dhe zgjerimin e strukturës organizative të Ministrisë së Forcës dhe Sigurisë së Kosovës (MFSK) ku do të themelohet Sektori i Ndërlidhjes dhe Përfaqësimit në kuadër të Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri në MFSK.

Qeveria e Republikës së Kosovës në Takimin e datës 14.12.2011 ka miratuar Planet Zhvillimore Strategjike për ZKM-në, MZHE-në dhe MKRS-në. Po ashtu Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur me 21.12.2011 ka miratuar Planin Zhvillimor Strategjik të Ministrisë së Financave (MF), ndërsa me 05.01.2012 është miratuar Plani Zhvillimor Strategjik i MD-së 2012-2016.

Ndërsa në mbledhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës së datës 13.10.2011 është miratuar dokumenti për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR).

Është bërë decentralizimi i disa përgjegjëseve të sistemit informativ të pagave të organizatave buxhetore (ku bëjnë pjesë lista e pagave, raporti financiar, dokumenti i urdhërpagesave dhe raporti financiar sipas strukturës së organizatës buxhetore). Në vazhden e avancimit të kapaciteteve në përdorimin e softuerit kompjuterik janë organizuar gjithsejtë 79 trajnime për organizata buxhetore, ku gjithsejtë 82 zyrtar kanë vijuar këto trajnime

Për më tepër është hartuar manuali për planifikimin e burimeve njerëzore në shërbimin civil të Kosovës dhe manuali për organizimin institucional.

Gjatë periudhës raportuese, Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) ka organizuar 33 kurse trajnime në fushat: menaxhim dhe administratë e përgjithshme, burime njerëzore, prokurim, BE-së, çështje komunale. Prioritet i lart në organizimin trajnimeve për këtë periudhë ishin trajnimet në mbështetje të Ligjit të Shërbimit Civil dhe të akteve nënligjore, trajnimet për prokurim publik, modulet për certifikatën e avancuar sipas ligjit të Prokurimit Publik, trajnimet në mbështetje të komunave, trajnimet për çështjet e BE-së. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë trajnuar gjithsej 1053 zyrtarë.

1.1.4. SISTEMI GJYQËSOR

Si pjesë e zbatimit të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nr. 03/L-191 janë miratuar UA për kalimin e kohës në lokalet e veçanta të institucionit korrektues, UA për pakot higjienike dhe pakot ushqimore, si dhe UA për menaxhimin zyrtar të arkivit të Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK), të publikuara më 26.10.2011.

Grupi punues për hartimin e rregullave për ristrukturimin e gjykatave, sipas Ligjit mbi Gjykatat, ka miratuar rregulloren dhe Planin për Zbatimin e Ligjit për Gjykata. Ky plan, ashtu siç përcaktohet edhe me Ligjin për Gjykata është miratuar dhe postuar në ueb faqe të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) më 01.12.2011.

Më datën 26.09.2011 është nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit në mes MD-së dhe Prokurorisë së Shtetit (PSh) për bartjen e Divizionit për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (DMNV) nga MD në PSh si dhe më datën 19.09.2011 është nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet MD-së dhe KGJK-së për bartjen e Divizionit për Integrim Gjyqësor.

Gjatë kësaj periudhe, duke u bazuar në numrin e përgjithshëm të pozitave të lira për gjyqtarë (112), 26 pozita janë shpallur për komunitetet joshqiptare. Gjatë këtij procesi janë emëruar pesë (5) gjykatës të Gjykatës Supreme: tre (3) shqiptar, një (1) serb, një (1) turk. Po ashtu janë dekretuar nga presidentja e Kosovës gjashtë (6) gjyqtarë, nga këta gjyqtarë, dy (2) janë dërguar për Gjykatën Ekonomike ndërsa katër (4) për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme si dhe është marrë vendim për shpalljen edhe të pesë (5) pozitave të reja për Dhomën e Posaçme. Për më tepër, janë licencuar 87 ndërmjetësit e parë të Republikës së Kosovës më 26.09.2011.

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve institucionale, gjatë periudhës shtator - dhjetor 2011 në Programin e Vazhdueshëm për Arsimim Ligjor (PVAL) janë organizuar 31 trajnime nga fusha të ndryshme. Numri i kandidatëve që kanë diplomuar në këtë periudhë, pasi që kanë përfunduar trajnimet në Programin Fillestar për Arsimim Ligjor (PFAL), është 32. Për më tepër, Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) ka organizuar 9 trajnime të specializuara ku gjithsej janë trajnuar 126 zyrtar, prej të cilëve 103 gjyqtar, 10 prokurorë dhe 13 të tjerë.

KGJK ka organizuar trajnime mbi zbatimin e doracakut për menaxhimin e gjykatave ku është përfshirë lidhshipi i të gjitha gjykatave. Në total janë trajnuar 53 kryetarë gjykatash dhe 53 administratorë gjykatash. Nga stafi i Këshillit të Pavarur Gjyqësor dhe Prokurorial (KPGJP) janë transferuar nëntë (9) punonjës në Zyrën për Emërime të KGJK-së.

Këshilli Prokurial i Kosovës (KPK) ka miratuar Planin e Zbatimit të ligjit për Prokurorin e Shtetit, i cili plan është shpallur në ueb faqen e Prokurorit të shtetit. KPK ka miratuar Rregulloren për strukturën organizative dhe funksionin mbështetës administrativ të zyrës së Prokurorit të shtetit. Më 05.12.2011, KPK ka emëruar drejtorin e përgjithshëm të Sekretariatit të KPK dhe Drejtorin e Njësitit për Vlerësimin e Performances së Prokurorëve. Gjatë vitit 2011, KPK ka emëruar 13 kandidat për Prokuror. Tetë prej tyre janë dekretuar nga Presidentja i Kosovës dhe pesë të tjerë janë në procedurë të dekretimit. KPK dhe Prokurori i shtetit ka plotësuar pothuajse gjithë stafin mbështetës të Prokurorëve.

Njësitë për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve ka instaluar aplikacionin e bazës së të dhënave nëpër të gjitha Prokuroritë e Kosovës, përveç asaj të Mitrovicës.

KPK ka themeluar zyrën për Trajnime, në kuadër të Njësitit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve.

Për më tepër, në fushën e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, janë mbajtur dy trajnime për gjithësejt 16 zyrtarët e Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (DBJN). DBJN gjatë periudhës raportuese ka proceduar rreth 1700 raste të pranuar nga shtetet e huaja, përjashtimisht me shtetet të cilat hezitojnë të bashkëpunojnë me MD-në e Kosovës.

Me qëllim të funksionalizimit të sistemit noterial në Kosovë, me datë 08.12.2011, MD ka aprovuar dy udhëzime administrative, UA për Procedurën e Konkurrimit dhe Përzgjedhjen e Zyrave Noteriale dhe UA për Numrin dhe Lokacionin e Zyrave, Lokaleve e Pajisjeve të nevojshme të Noterit. Me këto dy Udhëzime është kompletuar baza ligjore për konkurrim në sistemin noterial.

Në funksion të krijimit të një ambienti më të favorshëm për biznesin, më 19.09.2011 është certifikuar grupi i dytë prej 38 noterëve të Republikës së Kosovës.

1.1.5. POLITIKAT KUNDËR KORRUPSIONIT

Në kuadër të përmirësimit të zbatimit të kornizës ligjore kundër korrupsionit, Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK), gjatë muajit tetor ka hartuar një raport mbi vlerësimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit (SPVKK) 2009 - 2011, e cila ka qenë pjesë përbërëse e propozim Strategjisë Kundër Korrupsionit 2012–2016. SPVKK 2012-2016 është miratuar nga Qeveria me 11.01.2012.

Sa i përket deklaratimit të pasurisë nga ana e zyrtarëve të lartë publik, gjatë periudhës raportuese në AKK janë dorëzuar gjithsej 123 deklarata të pasurisë. Nga 1830 zyrtar që kanë bërë raportimin e rregullt vjetor të pasurisë, 20% e tyre kanë kaluar procesin e kontrollit të plotë.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar aktiviteteve me qëllim të ngritjes së vetëdijes së publikut në fushën e politikave kundër korrupsionit. AKK në bashkëpunim me Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) përmes Zyrës së Standardeve Profesionale ka organizuar trajnimin për zyrtarët e AKK-së. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe janë mbajtur prezantime në zyrat regjionale në Mitrovicë, Pejë, Gjakovë ku janë trajnuar rreth 100 zyrtarë të ATK-së.

AKK së bashku me UNDP dhe Asociacionin e Gazetarëve Profesionist të Kosovës (AGPK) më 09.12.2011, në ditën ndërkombëtare kundër korrupsionit kanë ndarë shpërblimet, tashmë tradicionale, të gazetarisë kundër korrupsionit. Po ashtu, AKK në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë (ZQM) (në kuadër të ZKM-së) po atë ditë ka organizuar një tryezë për të shënuar ditën ndërkombëtare kundër korrupsionit.

1.2. TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE

1.2.1 TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE

Në fushën e të drejtave të njeriut, Kuvendi ka përfunduar procedurën seleksionuese për plotësimin e 5 pozitave për Zëvendës të Avokatit të Popullit. Pas rekomandimeve të bëra tek Avokati i Popullit është bërë edhe emërimi i tyre.

Për më tepër është caktuar Zv/Kryeministri për të mbikëqyrur procesin e rishikimit të institucioneve që merren me të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve. Vendimi nga ana e Qeverisë është nënshkruar më 29.09.2011.

Në kuadër të përpjekjeve për zgjidhjen e çështjes së personave të pagjetur, Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 31 gusht 2011 ka miratuar projektligjin për Personat e Pagjetur, i cili është Dekretuar nga

Presidentja e Kosovës, në të njëjtën datë (nr. i dekretit: DL-023-2011). Gjatë kësaj periudhe raportuese janë përmbyllur punët në 13 lokacione, ndërsa mbetjet mortore të 27 personave të identifikuar gjatë kësaj kohe, ju janë dorëzuar familjarë. Më tej, gjatë muajit tetor 2011, i gjithë stafi i Komisionit Qeveritar për Personat e Zhdukur (KQPZh) është trajnuar rreth funksionimit të Bazës së të Dhënave - AMPM (antemortem-postmortem), nga ana e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.

Në fushën e Lirisë së Asociimit, Kuvendi ka miratuar plotësim-ndryshimin e Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare dhe është dekretuar nga Presidentja e Kosovës më 31.08.2011 (nr. i dekretit: DL-034-2011).

Janë hartuar raportet vjetore (2011) për fushën e të drejtave të njeriut dhe po të njëjtat janë publikuar dhe shpërndarë të gjithë akterëve relevant, ato janë si në vijim:

- Raporti mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Njeriut;
- Raporti mbi zbatimin e Planit Nacional të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara;
- Raporti mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Fëmijëve;
- Raporti për zbatimin e Planit Nacional të Veprimit për komunitetet Rom, Ashkali, Egjiptian.

Gjatë periudhës raportuese, MPMS-DIPS në realizimin planit të veprimit për shtrirjen e procesit të Monitorimit e Punës së Fëmijëve (MPF) në tërë territorin e Kosovës dhe me qëllim të ngritjes së kapaciteteve për MPF në nivelin lokal, ka mbajtur trajnime me Anëtarët e Komiteteve Lokale të Veprimit për Monitorimin e Punës së Fëmijëve. Trajnimet janë mbajtur në 31 komuna të Kosovës, ku janë trajnuar rreth 500 pjesëmarrës. Gjatë kësaj periudhe janë themeluar strukturat e Monitorimit të Punës së Fëmijëve në të gjitha komunat e Kosovës, përveç në pjesën veriore të Mitrovicës.

Më tej, me 07.09.2011 me Vendimin nr 04/36 është themeluar Këshilli Nacional për PAK, si dhe është finalizuar matrica për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian (KE) për çështjen e Komuniteteve RAE.

Më 14 nëntor 2011 Qeveria ka emëruar Kryeshefen e Agjencisë për Barazi Gjinore.

Në këtë periudhë është organizuar Konferenca Rajonale: "Fuqizimi i grave në vendimmarrje Kosova në rrugën e aderimit në BE" e organizuar me datë 23 - 24 shtator. Po ashtu me rastin e ditës ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj gruas, 25 nëntori, është promovuar Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje. Janë organizuar dy tryeza diskutimi: Zbatimi i Rezolutës 13 – 25 nëntor 'Gratë, Paqja dhe Siguria' dhe barazia gjinore nga perspektiva e Parlamentit të Studentëve të Universitetit të Prishtinës.

Janë përgatitur termat e referencës për Hulumtimin "Gratë dhe e Drejta e Pronësisë në tokë - Roli i Grave në përdorimin e tokës dhe pronësia në Kosovë". Në kuadër të forcimit të të drejtave pronësore, Komisioni për kërkesa pronësore i Kosovës në dy sesionet e mbajtura ka vendosur në shkallë të parë 4091 kërkesa të paraqitura. Ndërkaq nga trupi gjykues i Gjykatës Supreme të Kosovës si shkallë e dytë ka vendosur 37 kërkesa, prej tyre 6 ankesa janë pranuar/vendimi i Komisionit është ndryshuar, 30 ankesa janë refuzuar/vendimi i Komisionit është vërtetuar. Numri i përgjithshëm i vendimeve të implementuara nga Agjencioni Kosovar i Pronës (AKP) gjatë periudhës raportuese, duke përfshirë këtu të gjitha format e implementimit (riposedimi, administrimimi, mbyllja me kërkesën e palës etj.) është 2.829 kërkesa. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë kryer 232 dëbime fizike nga pronat.

1.2.2. TË DREJTAT E MINORITETEVE, TË DREJTAT KULTURORE DHE MBROJTJA E MINORITETEVE

Në fushën e të drejtave kulturore, për këtë vit është përfunduar faza e punimeve të masave preventive/emergjente në procesin e restaurimit dhe konzervimit të Kalasë së Prizrenit. Grupi ndërmintor për RAP ka miratuar Planin Zhvillimor Strategjik të MKRS-së për periudhën 2011-2014. Lista e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme me vlefshmëri një vjeçare, është miratuar më 30 shtator 2011.

Sa i përket zbatimit të legjislationit mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare është promovuar botimi i studimit "Politikat e gjuhëve në Kosovë". Në këtë periudhë raportuese Komisioni ka pranuar dhe shqyrtuar 6 ankesa të parashtruara nga subjektet përkatëse. Sa i përket forcimit të Komisionit të Gjuhëve në këtë periudhë raportues me Vendim të Qeverisë nr. 09-47 09.11.2011 është formuar Grupi

Punues Qeveritar për reformimin e Komisionit për Gjuhë si dhe krijimi i politikave mbi përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës. Ky grup punues qeveritar tani është në proces të punës rreth hartimit të rregullores së re që rregullon (reformon) përbërjen dhe kompetencat e Komisionit, i cili pas shlyerimit final do t'i dorëzohet Qeverisë për miratim. Janë realizuar edhe vizita - takime në institucionet qendrore me përfaqësuesit e Zyrës së Avokatit të Popullit, ku është bashkëpunuar në fushën e procedimit të ankesave që parashtrihen lidhur me përdorimin e gjuhëve.

Numri i pjesëtarëve jo shumicë të punësuar në institucionet e nivelit qendror është 2504 apo 9.5%, gjersa në institucionet e nivelit lokal është 4909 të punësuar apo 13.35%.

Sa i përket komunitetit RAE, faza e parë e projektit për strehimin e banorëve të lagjes "Ali Ibra" të komuniteteve RAE, është përfunduar dhe gjithsej 29 familje janë vendosur në shtëpi të reja. Në fushën e kthimit, gjatë periudhës raportuese janë kthyer 124 familje.

Lidhur me numrin e aktiviteteve `shko-shiko` janë mbajtur gjithsej 9 vizita me Personat e Zhvendosur Brenda Vendit (PZhBV) në 9 komuna të Kosovës.

Pas përfundimit të projektit në Pogradjë, gjatë muajit shtator u janë dorëzuar 13 shtëpi familjeve të kthyer të komunitetit serb si dhe është bërë shpërndarja e pakove ushqimore dhe orendive shtëpiake. Përmes investimit direkt në komunën e Shtërpcës janë ndërtuar 8 shtëpi për PZhBV-vët të komunitetit serb të cilat janë dorëzuar në shfrytëzim. Gjithashtu janë ndërtuar 51 shtëpi për të gjitha komunitetet, në të gjitha regjionet e Kosovës.

Me qëllim të integritimit të komuniteteve, gjithashtu janë përfunduar disa projekte infrastrukturore, aktivitetet e të cilave ishin: asfaltimi i rrugës Tropikanë – Preoce; ndërtimi i qendrës zejtare në Gushtericë të Poshtme; rindërtimi i ndërtesës së RTV Graçanica; ndërtimi i ujësjellësit në Osojan KK Istog; ndërtimi i rrugës rreth Kishës Sv Petke në Berevcë KK Shtërpcë; ndërtimi i rrugës hyrëse tek vendi i quajtur Livadë KK Shtërpcë; ndërtimi i rrugës Sveti Shtefan në KK Shtërpcë; ndërtimi i rezervuarit dhe kaptazhit për lagjen Merxhincë KK Shtërpcë; ndërtimi i urës në Livadë KK Shtërpcë; furnizimi me zhavor për shtrimin e rrugëve në fshatin Vitomiricë KK Pejë; renovimi i ndriçimit publik në fshatin Celinë KK Rahovec; rrethimi i varrezave në fshatin Celinë KK Rahovec; furnizimi me zhavor për shtrimin e rrugëve në fshatin Jashnicë KK Shtërpcë.

Për më tepër, projekti RRK II ka përfunduar përmes të cilit janë ndërtuar 214 shtëpi për të gjithë të zhvendosurit brenda dhe jashtë vendit në katër komuna të projektit: Klinë, Ferizaj, Obiliq dhe Rahovec, si dhe është bërë ndarja e pakove të harmonizuara të ndihmave (asistenca humanitare) me rastin e kthimit të PZh-ve (ushqim, orendi, teknikë, lëndë djegëse dhe ndarja e granteve).

Gjatë kësaj periudhe janë financuar 43 projekte të OJQ-ve të komuniteteve pakicë, projekte që kanë qëllim zhvillimin dhe integrimin e komuniteteve pakicë në Kosovë. Vlera e projekteve arrin shumë më prej 213,075.97 euro. Gjithashtu me qëllim të përkrahjes për zhvillimin dhe ri-integrimin e qëndrueshëm të komuniteteve pakicë si dhe zhvillimin ekonomik të tyre, është bërë shpërndarja e këtyre materialeve:

Materialit ndërtimor në vlerë prej 1.900,251.97 euro,

Pakove ushqimore prej 300 sosh,

Lëndë djegëse (dru) prej 565 m³.

1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE

Në bazë të detyrimit të përmbushjes së kontributit vjetor të Qeverisë së Kosovës në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal, Republika e Kosovës e ka përmbushur obligimin e saj financiar ndaj RCC (vendimi për pagesë prej 40.000 euro është marrë me datë 15.09.2011). Gjatë muajit tetor 2011, duke marr parasysh fuqizimin ndërqeveritar, Koordinatorin e ri Nacional për koordinimin e të gjitha iniciativave dhe mekanizmave rajonale është emëruar.

MZHE ka marr pjesë në takimet e rregullta në kuadër të TKE-së, Këshillin Ministror (tetor 2011), Forumi i përhershëm i nivelit të lartë (tetor, dhjetor 2011); Task Forca për Ambient (tetor 2011); Task Forca për EE (nëntor 2011); Task Forca për BRE (dhjetor 2011); Task Forca për Strategjinë Rajonale të Energjisë (dhjetor 2011).

Gjatë kësaj periudhe raportuese është mbajtur takimi i Grupit Punues për Tregtinë mbi Shërbime në Prishtinë, si dhe punëtorja e organizuar për Masat Mbrojtëse. Ndërsa gjatë nëntorit në Paris është mbajtur takimi i Komitetit të Përbashkët dhe Java e CEFTA-s.

Në dhjetor, gjatë raundit të tetë të dialogut teknik të ndërmjetësuar nga BE-ja është arritur marrëveshja për Menaxhimin e Integruar të Kufijve (MIK) Kosovë – Serbi. Për realizimin e kësaj marrëveshjeje do të formohet një grup trepalësh implementues i kryesuar nga BE-ja, i cili parasheh nënshkrimin e një Protokollit Teknik ku do të parashihen të gjitha detajet teknike. Programi i BNK Kosovë - Mali Zi është miratuar nga KE në dhjetor 2011, ndërsa marrëveshja financiare për implementimin e programit IPA, bashkëpunimi ndërkufitar Kosovë - Shqipëri është nënshkruar në shtator 2011. Gjithashtu janë themeluar komitetet e përbashkëta monitoruese për programet BNK Kosovë - Maqedoni dhe Kosovë - Shqipëri.

2. KRITERET EKONOMIKE

2.1. FUNKSIONIMI I EKONOMISË SË TREGUT

Gjatë muajit tetor, buxheti për vitin 2012 është harmonizuar plotësisht me rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) të specifikuara si një prej kriterëve strukturore për fund të vitit 2012. Buxheti 2012 është aprovuar në Kuvendin e Kosovës më datë 20.12.2011.

Në përputhje me kërkesat nga Komisioni Evropian, në tetor 2011 është mbajtur takimi i radhës i Mekanizmit të Mbikëqyrjes Fiskale ku është raportuar mbi zhvillimet e fundit ekonomike si dhe procesin e hartimit të buxhetit 2012.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe FMN ka bërë vlerësimin e parë të programit SMP (Staff Monitored Program) për periudhën qershor - shtator 2011. Të gjitha kriteret kuantitative të përcaktuara për fund të shtatorit 2011 janë përmbushur me përjashtim të akumulimit të borxheve të papaguara të Qeverisë ndaj furnitorëve, të cilat janë akumuluar në vlerë të ulët. Në përputhje me këto zhvillime, FMN ka lëshuar vlerësim pozitiv mbi performancën makroekonomike të Kosovës për periudhën brenda programit SMP. Në harmoni me vlerësimin pozitiv të performancës makroekonomike nga ana e FMN-së, Banka Botërore (BB) në dhjetor ka bërë disbursimin e fondeve në vlerë prej €20 milionë si ndihmë direkte buxhetore brenda vitit 2011 në përkrahje të programit të punësimit të qëndrueshëm.

2.1.1. RAPORTIMI NË LIDHJE ME ZHVILLIMET E FUNDIT EKONOMIKE

Për sa i përket rritjes ekonomike për vitin 2011, të dhënat aktuale rreth trendëve të sektorëve kyç të ekonomisë sugjerojnë që ekonomia e Kosovës vlerësohet të ketë shënuar rritje prej 5.3% gjatë vitit 2011. Kësaj rritjeje vlerësohet t'i ketë atribuuar kryesisht konsumi dhe investimet. Për më shumë, konsumi vlerësohet të ketë kontribuar me 5% në rritjen reale të BPV-së përderisa investimet me rreth 2.0%. Përkundër rritjes së konsiderueshme të eksportit, eksporti neto mbetet përsëri kontribuuesi negativ në rritjen reale i cili vlerësohet të ketë kontribuar negativisht me 1.7% në rritjen reale të BPV-së gjatë vitit 2011. Kontributi negativ në rritjen reale të ekonomisë vlerësohet të ketë dhënë edhe reduktimi i prezencës së donatorëve në Kosovë.

Më saktësisht, bazuar në të dhënat e importit dhe të kreditimit nga ana e sektorit financiar, investimet private janë vlerësuar të jenë rritur me 11.1% gjatë vitit 2011, me kontribut të balancuar në mes të investimeve publike dhe private. Konsumi i përgjithshëm, në anën tjetër, vlerësohet të ketë shënuar një rritje prej 11.4% ku krahas rritjes së konsumit privat, rritja e pagave të kategorive të caktuara të shërbyesve civil po ashtu vlerësohet të ketë dhënë kontribut të rëndësishëm në rritjen e konsumit të përgjithshëm. Për më shumë, rritja nominale e komponentëve të BPV-së gjatë vitit 2011 mund t'i atribuohet edhe ngritjes së nivelit të çmimeve edhe pse të dhënat mbi sasinë e mallrave të importuara e që kryesisht përdoren për konsum dhe investime tregojnë për një rritje të konsiderueshme të këtyre komponentëve edhe në vlerë reale.

Për sa i përket sektorit të jashtëm, gjatë vitit 2011 deficitit tregtar vlerësohet të ngritet për rreth 0.3% në raport me BPV-në krahasuar me vitin 2010 kur edhe u shënuar një përmirësim në krahasim me vitin 2009. Për sa i përket vitit 2011, eksporti i mallrave vlerësohet të shënoj një rritje prej 7% përderisa importi i mallrave vlerësohet të rritet me 11%. Këto zhvillime tregojnë që edhe përkundër faktit që eksportet në vitet e fundit kanë shënuar një rritje të konsiderueshme, për shkak të bazës së ulët si dhe për shkak të projekteve të mëdha investuese të cilat stimulojnë në masë të madhe importin, nuk mund të pritët të ketë ndonjë përmirësim të konsiderueshëm në bilancin e llogarisë rrjedhës.

Duke u bazuar në faktin se ekonomia e Kosovës është një ekonomi e vogël dhe e hapur, ndikimi i lëvizjeve në tregjet botërore është i pashmagshëm. Në këtë kontekst, rritja e çmimeve ndërkombëtare, kryesisht e ushqimit dhe naftës, është reflektuar pothuajse drejtpërdrejt edhe në Indeksin e Çmimeve të Konsumit (IÇK) në Kosovë. Për më shumë, IÇK gjatë vitit 2011 ka shënuar një rritje mesatare vjetore prej 7.4% e ndikuar kryesisht nga rritja e çmimeve të bukës dhe naftës, sidomos gjatë gjysmë-vjetorit të parë të po këtij viti.

Tabela : BPV nominale dhe rritja reale e saj

Pershkrimi	2007	2008	2009	2010	2011
	Aktuale	Aktuale	Aktuale	Aktuale	Aktuale
<i>Ne miliona euro, perveç nese specifikohet ndryshe</i>					
Konsumi	3,811	4,345	4,280	4,531	5,036
Investimet	893	1,094	1,166	1,369	1,521
Eksportet neto	-1,309	-1,587	-1,534	-1,710	-1,902
BPV	3,394	3,851	3,912	4,190	4,655
Rritja reale e BVP-së, në %	6.3%	6.9%	2.9%	3.9%	5.3%
ICK, NE %	4.5%	9.2%	-2.4%	3.5%	7.4%

Burimi: ESK dhe parashikimet e Departamentit të Makroekonomisë, MF

Metodologjia e përdorur për kalkulimin e rritjes reale është ndryshuar në pajtim me metodologjinë e përdorur nga Enti Statistikor i Kosovës (ESK). Rritjet për vitet 2007 - 2010 janë kalkuluar nga ESK, duke paraqitur rritjen reale në krahasim me vlerën nominale të vitit paraprak. Me të njëjtën metodologji është bërë edhe vlerësimi i rritjes reale për vitin 2011 dhe vitet vijuese nga ana e MF. Parashikimi është rifreskuar bazuar në të dhënat e fundit të publikuara nga ESK dhe Banka Qendrore e Kosovës (BQK).

Zhvillimet në Bilancin e Pagesave

Sa i përket zhvillimeve në sektorin e jashtëm, të gjitha vlerësimet sugjerojnë që fundi i vitit 2011 do të karakterizohet me përmirësim në llogarinë kapitale dhe financiare.

Thellimi i vlerësuar i vlerës nominale të llogarisë rrjedhëse gjatë vitit 2011 pritet të vijë si rrjedhojë e rritjes së konsumit dhe investimeve, e cila pritet të rritë edhe më shumë importin e mallrave dhe të thellojë edhe më tej deficitin tregtar. Më saktësisht, parashikimet për vitin 2011 tregojnë që bilanci tregtar do të arrijë vlerën €1,988 milionë e që korrespondon me një ngritje vjetore prej 11.9% krahasuar me vitin 2010. Si rrjedhojë, deficitin e llogarisë rrjedhëse, pritet të përkeqësohet gjatë vitit 2011, e që në raport me BPV-në vlerësohet të shënojë një rritje prej 1.6% duke përfaqësuar 19.1% të BPV-së.

Me saktësisht, të dhënat për tregtinë me jashtë për dhjetë-mujorin e vitit 2011 tregojnë se eksportet kanë vazhduar të rriten për 10.8% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2010 duke arritur vlerën prej €268,8 milionë. Në anën tjetër, importet janë rritur me një normë prej 14.7% duke arritur shumën prej €2,006 milionë. Ky relacion i zhvillimit në komponentët kryesorë të bilancit tregtar ka bërë që ky bilanc për këtë periudhë të përkeqësohet për 15.3% për dallim nga periudha e njëjtë e vitit 2010. Deri në fund të vitit, eksporti parashihet të arrijë vlerën prej €325 milionë përderisa importet pritet të kapin vlerën prej €2,313 milionë.

Investimet e huaja direkte të cilat përbënin rreth 8.6% të BPV-së gjatë vitit 2010 pritet të arrijnë vlerën prej €385 milionë në fund të vitit 2011 duke shënuar një ngritje prej 6.4% krahasuar me vitin 2010 (Për të dhëna detaje të shpërndarjes së FDI nëpër sektorë shih tabelën në aneks). Ndërsa remitancat të cilat përbënin rreth 10% të BPV-së, sipas të dhënave preliminare, pritet të shënojnë një ngritje prej 5.3% në vitin 2011, me një diferencë në vlera nominale prej €22 milionë nga viti 2010. Megjithatë, edhe pse kriza e ekonomisë së disa vendeve të euro-zonës mund të ndikojë në trendin e remitancave gjatë fundit të vitit 2011, vlerësimet për këtë kategori të të hyrave janë mjaft konservative dhe mund të arrijnë vlerën e parashikuar.

Trendet në punësim

Bazuar në të dhënat e regjistruara mbi numrin e të papunëve nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), numri kumulativ i të regjistruarve si të papunë në fund të tetorit 2011 ishte 334,559 duke shënuar një rënie të lehtë prej 0.3% krahasuar me numrin e të regjistruarve në periudhën e njëjtë të vitit 2011.

Nga ana tjetër, numri i të punësuarve përmes zyrave të punësimit deri në fund të muajit tetor 2011 arriti në 6,517 persona. Vetëm gjatë muajit tetor 2011 janë regjistruar 1,523 persona si të papunë ndërsa që janë punësuar 740 persona.

Indekset e trendit të inflacionit (mundësisht HICP) (inflacioni bazë)

Në vitin 2011 kishte ngritje të konsiderueshme të nivelit të përgjithshëm të çmimeve krahasuar me një stabilitet të çmimeve gjatë vitit 2010 (ku inflacioni në fund të vitit 2010 ishte 3.5%). Për sa i përket vitit 2011, presionet inflacioniste ishin më të theksuara në gjysmën e parë të vitit, ku IÇK për gjashtë mujorin e parë të vitit ishte në mesatare 9.6%. Përderisa IÇK për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ishte 1.4%. Pjesa e dytë e vitit 2011 tregoj për një rënie të vazhdueshme në çmimet e përgjithshme, ku rënia më e theksuar u shënuar gjatë muajve tetor dhe nëntor ku IÇK shënoj 4.7% dhe 4.2% respektivisht. Bazuar në të dhënat e ofruara nga ESK vërehet se IÇK për periudhën janar – nëntor ishte në mesatare 7.7%.

Përgjatë pjesës së parë të vitit 2011, inflacioni ishte i udhëhequr kryesisht nga rritja e çmimit të bukës dhe të grurit. Po ashtu kontribut në rritjen e inflacionit ka pasur edhe ngritja e çmimeve të naftës. Në fund të muajit nëntor 2011, çmimet e bukës dhe drithërave shënuan një ngritje vjetore prej 6.2%, vajrat dhe yndyrat shënuan ngritje prej 5.7%, ndërsa nafta dhe benzina shënuan një ngritje mesatare vjetore prej 15.9%. Përderisa rënie e çmimeve u vërejt në produktet e perimeve.

Nëse shikojmë IÇK-në përjashtuar çmimet e naftës dhe ushqimit (e paraqitur grafikisht në aneks), shohim se IÇK shënoi në mesatare 2% për periudhën janar – qershor dhe 1.5% për periudhën gusht – nëntor. Për më shumë, nëse përjashtojmë nga ky indeks vetëm çmimet e naftës, del se IÇK për periudhën janar – qershor ishte 9% dhe 4.9% për periudhën gusht – nëntor. Këto të dhëna japin një indikacion se niveli i përgjithshëm i çmimeve është i ndikuar në masë të konsiderueshme nga lëvizja e çmimeve të ushqimit dhe pjesërisht nga çmimet e naftës.

2.1.2. RAPORTI PËR POLITIKAT MONETARE DHE FISKALE GJATË PERIUdhËS RAPORTUESE EVOLUIMI I KORNIZËS SË POLITIKAVE MONETARE

Korniza e normës së këmbimeve: Kosova përdor euron prandaj norma nominale e këmbimit përcaktohet nga lëvizjet e euros kundrejt valutave tjera në tregjet ndërkombëtare. Sa i përket normës reale efektive të këmbimit, këto kalkuloohen duke marrë për bazë çmimet e konsumit të vendeve të cilat kanë pjesëmarrje të madhe në tregtinë me Kosovën. Siç mund të shihet nga Tabela 2, totali i Normës Reale Efektive të Këmbimit (REER) pas një vlerësimi të konsiderueshëm përgjatë pjesës së parë të vitit 2011 duke bërë produktet vendore më pak konkurrues, filloi të zhvlerësohet në pjesën e dytë të vitit për të përmirësuar pozitën konkurruese karshi partnerëve tregtar. Ky trend vlerësimi përgjatë pjesës së parë të vitit dhe zhvlerësimi në pjesën e dytë të vitit ishte i ngjashëm si për partnerët tregtar brenda BE-së ashtu dhe për partnerët brenda CEFTA-s.

Tabela 2: Normat efektive të këmbimit, nominale dhe reale

		2011										
INDEKSI	Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	
	NEER	100.9	101.1	100.6	101.3	100.9	101.0	101.0	101.0	101.0	101.1	101.2
	REER (Total)	106.6	108.1	107.7	107.0	106.6	105.9	105.9	105.9	105.9	105.2	105.1
	REER (CEFTA)	106.2	107.7	106.6	106.6	106.3	106.0	106.0	106.0	106.0	106.5	106.3
	REER (EU)	108.2	110.0	110.1	108.1	108.1	107.2	107.1	107.0	107.0	106.2	107.0

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Evoluimi i politikave fiskale

Me buxhetin e vitit 2011 janë përcaktuar shpenzime në nivelin prej €1,434 milion, ndërsa të hyrat e projektuara kapin shumën prej €1,261 milion. Nën supozimin e realizimit të plotë të të hyrave dhe shpenzimeve të projektuara, atëherë pritët që deficitin primar në vitin 2011 të jetë €173 milion, ndërsa deficitin i përgjithshëm (që përfshinë pagesën e interesit dhe kredi-dhënien për ndërmarrjet publike) do rezultojë në €227 milion.

Në përputhje me kriteret e përcaktuara me marrëveshjen SMP me FMN, Qeveria e Kosovës ka arritur të realizoj ekzekutimin e shpenzimeve brenda tavanëve të përcaktuara me këtë marrëveshje. Në përputhje me këtë marrëveshje, si rezultat i vonesës së privatizimit të Post-Telekomit të Kosovës (PTK) dhe me qëllim të ruajtjes së nivelit të kënaqshëm të bilancit bankar, MF nuk ka alokuar një fond prej €60 milion nga Buxheti i vitit 2011. Ky fond është ndarë nga: shpenzimet kapitale-përfunduar shpenzimet e autostradës (€30 milion), huadhënia për ndërmarrje publike (€15 milion) dhe nga mallrat dhe shërbimet (€7 milion). Për më shumë, Qeveria është zotuar të ndjekë kriteret kuartale të përmbushjes së objektivave fiskale, kriteret këto që do rishikohen po në të njëjtin afat kohor nga stafi i FMN-së. Në bazë të marrëveshjes SMP, taveni i shpenzimeve primare deri në dhjetor 2011 është €1,433 milion.

Për vitin 2011, nga ATK është planifikuar të arkëtohen €261 milion. Deri në fund të nëntorit 2011, ATK ka arritur të arkëtojë €240.8 milion, apo 92% të vlerës së projektuar vjetore. Ndërsa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010, ku të hyrat e grumbulluara ishin në vlerë prej €203 milion, vërehet një ngritje prej 19%.

Të hyrat në kufi të projektuara për tu mbledhur me buxhetin e vitit 2011 kapin shumën €831 milionë. Autoritetet doganore, deri në fund të nëntorit 2011, kanë arritur që të arkëtojnë €745.8 milionë, apo 90% të vlerës së projektuar vjetore. Krahasuar me vlerën e arkëtuar gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2010, vërehet një ngritje prej 18% në vlerën e të hyrave të grumbulluara.

Ndërkaq të hyrat jo tatimore dhe të hyrat vetanake (komunale dhe qendrore) për vitin 2011 janë projektuar në vlerë prej €159 milion. Nga këto të hyrat jo-tatimore janë parashikuar €45 milion nga të cilat deri në nëntor janë arkëtuar €41.6 milion apo 92% e planit. Ndërsa të hyrat vetanake (komunale dhe qendrore) janë parashikuar në vlerë prej €113 milion, nga të cilat deri në nëntor janë arkëtuar €99.2 milionë apo rreth 89 % e planit vjetor. Po ashtu gjatë kësaj periudhe janë arkëtuar edhe €15 milion dividendë shtesë nga ajo që është planifikuar në fillim të vitit duke rezultuar në total vlerën e arkëtuar nga dividendat në €60 milion.

Gjatë periudhës janar - nëntor janë shpenzuar €1,178.25 milion, apo rreth 77% e vlerës së buxhetuar. Ky nivel shpenzimesh është për 12% më i lartë se sa niveli i shpenzimeve të regjistruara për periudhën e njëjtë të vitit 2010. Deri në këtë periudhë, 79% e shpenzimeve janë realizuar nga Qeveria qendrore ndërsa 74% e shpenzimeve janë realizuar nga Qeveria lokale.

Në nivelin qendror, shpenzimet kapitale janë realizuar në normën prej 69% gjatë periudhës janar - nëntor 2011, ndërsa në nivelin komunal këto shpenzime janë realizuar në nivelin prej 65%. Në total, gjatë periudhës së raportuar janë shpenzuar €449.2 milion në shpenzime kapitale, ndërsa janë shpenzuar €688 milion në shpenzime rrjedhëse (nga të dyja nivelet e qeverisjes). Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, i janë disbursuar €29.0 milion Korporatës Energjitike të Kosovës (KEK) në formë kredie. Tabela 4 në aneks paraqet shpenzimet sipas nën-kategorive për qeverinë qendrore dhe qeverinë lokale.

Duke marrë për bazë nivelin e të hyrave dhe shpenzimeve, deri në fund të nëntorit 2011, buxheti i Republikës së Kosovës ka rezultuar me një deficit në vlerë prej €15.8 milion. Kjo edhe ka ngritur nivelin e përgjithshëm të bilancit bankar gjatë kësaj periudhe për €18.25 milionë.

MF në nëntor 2011 ka hartuar pakon e re fiskale, bazuar në sugjerimet e grupeve të ndryshme të interesit, siç janë Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), Oda Ekonomike Amerikane (OEA), Aleanca Kosovare e Biznesit (AKB) si dhe Ministrinë e Linjës (ML). Fokusi i kësaj pakoje të re fiskale është bërja e Kosovës një ambient tërheqës për punën e bizneseve, me sa më pak çrregullime që është e mundur.

Kjo pako përmban disa skenarë që do t'i favorizonin si bizneset e reja ashtu edhe ato ekzistuese. FMN-ja ka dhënë sugjerimet dhe kritikën e tyre për këtë çështje. Disa nga propozimet e kësaj pakoje kanë filluar zbatimin në kuartalin e katërt të këtij viti, si:

Aplikimi i normave më të ulëta të interesit për vonesa në tatime;

Ndryshimet në akcizë duke zgjatur limitin e vjetërsisë dhe rritjen e normave të akcizës sipas fuqisë së motorit dhe vjetërsisë së automjeteve;

Aplikimi i akcizës në lojërat e fatit;

Borxhi i përgjithshëm i qeverisë: Borxhi publik i Republikës së Kosovës përfshinë mjetet (huadhëniet) e ofruara nga agjencitë ndërkombëtare. Borxhi publik është kryesisht i përbërë nga kreditë e buta ku €22 milion janë kredi nga FMN të cilat u morën gjatë marrëveshjes SBA gjatë vitit 2010 dhe pjesa tjetër janë obligime ndaj BB lidhur me borxhin e trashëguar nga periudha e ish Jugosllavisë si dhe kreditë e tjera të buta të lëshuara nga BB dhe KFW që janë të koncentruar në përmirësimin e administratës publike dhe përmirësimin e infrastrukturës, veçanërisht të energjisë dhe furnizimit me ujë. Deri më tani, stoku i borxhit publik i Kosovës arrin në €248.4 milionë ose rreth 5.34% e BPV-së, një përqindje e ulët e borxhit nëse i referohemi traktatit të Maastrichtit i cili e definon limitin e financimit me borxh për shtet që është deri në 60% të BPV-së. Shuma totale e paguar për servisim të borxhit deri në fund të nëntorit të vitit 2011 ka qenë €11.45 milionë, nga të cilat €6.8 milionë kanë qenë për pagesë të kryegjësë dhe €4.5 milionë për pagesë të interesit.

2.1.3. FUNKSIONIMI I TREGJEVETË PRODUKTEVE

Liberalizimi i çmimeve Madhësia e sektorit privat

Gjatë kësaj periudhe, konsumi privat nuk ka pasur lëvizje të theksuar duke mbetur kështu në një mesatare prej 91.5% të BPV-së. Ndërsa, investimet private janë vlerësuar të kenë pësuar një rënie të vogël në vitin 2011 si përqindje e BPV-së e kjo si rezultat i rritjes më të shpejtë të komponentëve tjera të BPV-së, në këtë rast rritjes më të përshpejtuar të investimeve kapitale gjatë vitit 2011 krahasuar me vitin 2010. Megjithatë vlen të ceket se investimet private në vlerë nominale gjatë vitit 2011 kanë shënuar ngritje krahasuar me vitin 2010.

Tabela 3: Pjesëmarrja e sektorit privat në BPV

Përshkrimi	2009	2010	2011
Konsumi privat	92.3%	91.2%	91.5%
Investimet private	19.6%	21.8%	21.6%

Privatizimi

Gjatë periudhës raportuese, gjithsej 1,137 punëtor nga 12 Ndërmarrje Shoqërore (NSh) kanë përfituar nga shpërndarja e parakohshme e 20% të të ardhurave të disponueshme nga shitja e ndërmarrjeve respektive, me shumë totale 2,827,778 €.

Hyrja dhe dalja e bizneseve

Gjatë periudhës raportuese shtator - dhjetor 2011 në ARBK janë regjistruar 2,373 biznese të reja kurse ndryshime në bizneset ekzistuese janë bërë në 1,367 biznese dhe janë shuar 311 biznese. Gjatë kësaj periudhe në Zyrën e Pengut janë regjistruara 10,964 Pengje.

Ambienti biznesor, sistemi gjyqësor dhe kapacitetet administrative Poashtu, më 26.09.2011, janë licencuar 87 ndërmjetësit e parë të Republikës së Kosovës.

2.1.4. SEKTORI FINANCIAR

Vlera totale e aseteve të sektorit financiar të Kosovës deri në shtator 2011 ishte €3.4 miliardë. Sistemi bankar vazhdoi të ketë pjesëmarrjen më të madhe në sektorin financiar (77.1% të gjithsej aseteve). Fondet pensionale menaxhuan me 16% të aseteve, ndërsa pjesa tjetër e aseteve u ndanë mes institucioneve mikrofinanciare (3.7% e aseteve), kompanitë e sigurimit (3.1% e aseteve) dhe ndihmësve financiarë (0.1% e aseteve). Lidhur me numrin e institucioneve financiare në Kosovë, viti 2011 nuk u karakterizua me ndonjë ndryshim substancial. Numri i bankave komerciale dhe fondeve pensionale mbeti i njëjtë si në vitin paraprak gjersa një institucion mikrofinanciar ndërpreu operimin në treg.

Struktura e pronësisë së sektorit bankar në Kosovë nuk ka ndryshuar që nga viti 2008, duke u përbërë nga 6 banka në pronësi të huaj dhe dy në pronësi vendore. Sektori mbetet i dominuar nga bankat e huaja, të cilat menaxhojnë rreth 90% të asetëve bankare. Për më tepër, sektori bankar karakterizohet me një shkallë relativisht të lartë të koncentrimit. Kjo ngase tri bankat më të mëdha në vend menaxhojnë rreth 70% të asetëve bankare (deri në shtator 2011). Sidoqoftë, në vitet e fundit, shkalla e koncentrimit ka rënë në vazhdimësi. Shkalla e koncentrimit e shprehur përmes Indeksit të Herfindahl-Hirschman (HHI) për asete ka rënë në 2,109 pikë (shtator 2011), krahasuar me 2,344 pikë (shtator 2010).

Deri në shtator 2011, vlera e përgjithshme e kredive të lëshuara nga sistemi bankar i Kosovës ishte €1.66 miliardë (rreth 35% e BPV). Po ashtu, deri në shtator 2011, aktiviteti huadhënës i bankave shënoi një rritje të dukshme të normës vjetore prej 16.8%, krahasuar me 10.9% sa ishte në shtator 2010. Një normë më e përshpejtuar e rritjes në 2011 u regjistrua në kreditë për ndërmarrjet 16.4% (4.0% në shtator 2010), që është indikacioni i rritjes së besimit të sistemit bankar drejt bizneseve. Kreditë për ekonomitë familjare vazhduan të rriten me një ritëm të ngadalësuar prej 18.1% (28.3% në shtator 2010).

Struktura e kredive në 2011 u dominua nga kreditë e dhëna ndërmarrjeve, që përbënin rreth 69.9% të gjithë kredive, ndërsa pjesa tjetër prej 30.1% i lëshuar ekonomive familjare. Niveli i ulët i prodhimit në ekonominë e Kosovës dhe mbështetja e lartë në importet nga jashtë është reflektuar edhe në shpërndarjen sektoriale të kredive për ndërmarrjet private. Pjesa më e madhe e kredive ishte absorbuar nga sektori i shërbimeve (72.1%), pasuar nga kreditë e industrisë (24.2%), bujqësisë (3.5%), etj.

Profiti neto i sektorit bankar deri në shtator 2011 ishte €24.6 milionë ose 8.4% më i ulët se sa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Zvogëlimi i profitit gjatë vitit 2011 kryesisht është shkaktuar nga rritja më e shpejtë e shpenzimeve bankare krahasuar me rritjen e të hyrave bankare.

Sidoqoftë, të gjitha bankat që operojnë në Kosovë janë mirë të kapitalizuara dhe në vazhdimësi e mbajnë Treguesin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (TMK) mbi kriterin minimal prej 12% të përcaktuar nga BQK. Në shtator të vitit 2011, TMK qëndroi në 17.1%. Gjatë kësaj periudhe, pjesëmarrja e kredive jo-performuese u rrit në 6.0% (4.6% në shtator 2010). Megjithatë, kreditë jo-performuese vazhdojnë të jenë mirë të mbuluara me provizione për humbje nga kreditë (117.2%).

Viti 2011 u karakterizua me një rënie të lehtë të normave të interesit si për kreditë ashtu edhe për depozitat. Norma mesatare e interesit për kreditë deri në shtator 2011 ishte 14.3% (14.7% në shtator 2010), dhe norma mesatare për depozita ishte 3.5% (3.7% në shtator 2010).

Portfolio investimet jashtë vendit në nëntë muajt e parë të vitit 2011 shënuan rënie prej rreth 32.3%, duke arritur në €126.9 milion (€187.5 milion deri në shtator 2010). Zhvillimet në tregun financiar global mund të konsiderohen si një nga kontribuuesit në rënie të portfolio investimeve. Nga gjithsej €126.9 milion të portfolio investimeve, 75% janë investime të fondeve pensionale, derisa 25% janë investime të bankave komerciale të Kosovës. Shumica e portfolio investimeve jashtë vendit ishin të përbërë nga instrumentet e tregut financiar dhe investimeve në tregun e kapitalit.

2.2. KAPACITETI PËR TË PËRBALLUR ME PRESIONIN E KONKURENCËS DHE FORCAVETË TREGUT BRENDA UNIONIT

2.2.1. KAPITALI NJERËZOR DHE FIZIK

Kapitali njerëzor: Në interes të një funksionimi më të mirë të tregut të punës dhe një harmonizimi më të mirë të ofertës dhe kërkesës për zbutjen e papunësisë strukturale në Kosovë, Divizioni i Punës dhe Punësimit gjatë periudhës shtator- dhjetor 2011, përmes Shërbimeve Publike të Punësimit ka ndërmjetësuar në punësim rreth 274 punëkërkues të të gjitha minoriteteve, përfshirë komunitetet Romë, Ashkali dhe Egjiptas (RAE).

Në këtë periudhë kohore Shërbimet Publike të Punësimit kanë regjistruar 3051 punëkërkues të rinj, prej tyre femra 1529, minoritete 371 dhe 17 me aftësi të kufizuara, si dhe kanë ndërmjetësuar në punësim 1499 punëkërkues, nga të cilët femra ishin 340. Të dhënat e lartë cekura janë vetëm të muajit shtator dhe tetor për arsye se informata e tregut të punës për dy muajt e fundit publikohet në janar të vitit që vjen. Gjatë periudhës shtator - dhjetor 2011 me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës në shërbimet publike të punësimit, janë ndërtuar 3 zyra komunale të punësimit (në Malishevë, Viti dhe

Obiliq) si dhe është bërë renovimi i objektit për zyrën e punësimit në Istog.

Në kuadër të projektit 'Kosova e Bukur' deri në fund të nëntorit 2011 janë implementuar 7 nga 19 projektet e përzgjedhura. Nga 7 projektet e implementuara deri tani janë punësuar 163 punëkërkuar. Nga ky numër, 55 nga grupet e marginalizuara (të rinj 40, gra 1, persona me aftësi të kufizuara 11, nga minoritetet 3).

Për periudhën shtator - nëntor 2011 në 8 Qendra të Aftësimin Profesional (QAP) dhe 6 njësitë e tyre mobile kanë përfunduar trajnimin dhe janë certifikuar 382 kandidatë. Përmes skemave 'Trajnim i Drejtpërdrejtë në Kompani dhe Institucione' janë përfshirë punëkërkuar në projektet si më poshtë

Përmes projektit Lux-Development janë trajnuar 219 punëkërkuar (trajnim dy mujor),

Përmes projektit UNDP janë trajnuar në kompani dhe institucione 266 punëkërkuar (trajnim tre mujor).

Në lidhje me të dhënat e braktisjes së shkollave në nivelin e mesëm të lartë, gjatë periudhës 2010 - 2011 shkollën e braktisën 3,135 nxënës (2.9% e totalit), ku prej tyre 876 (ose 1.8%) janë femra.

Kapitali fizik

Sa i përket infrastrukturës rrugore, ka vazhduar ndërtimi i autostradës Morinë - Merdar, ku kanë përfunduar punimet në segmentet 1 - 4b (Vërmicë – Prizren – Suharekë – Sllapuzhan), me gjatësi prej 38 kilometrash, si dhe kanë filluar punimet në segmentin 5 (Qafa e Duhles – Udhëkryqi M9 Gjurgjicë) ku janë hapur 8 km trase. Po ashtu, në kuadër të projektit zbatues për segmentin 4 dhe 5 Suharekë – Dule ka përfunduar udhëkryqi M9 Gjurgjicë. Në funksion të përmirësimit dhe zhvillimit të infrastrukturës rrugore në periudhën raportuese përmes projektit të zgjerimit të rrugëve nacionale M9 dhe M2 janë kryer aktivitetet në vijim: Segmenti M9 Sllatinë – Gjurgjicë në tërësi është realizuar deri në masën 93% ku realizimi i punimeve përfshinë asfaltimin e shiritave qarkullues dhe punimet në struktura; në segmentin M2 Shkabaj – Milloshevë, realizimi i përgjithshëm i projektit është 90%; ndërkaq në programin e rehabilitimit të rrugëve kanë përfunduar në tërësi 30 km rrugë rajonale dhe 85.4 km rrugë lokale.

Në sektorin e energjisë, me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe ngritjes së kapaciteteve transmetuese dhe transformuese në rrjetin e transmissioin në periudhën raportuese KOSTT është duke finalizuar implementimin e Paket Projektit 400/110 kV Ferizaj 2. Në këtë kuadër, ka përfunduar projekti LOT 1 (me 17.10.2011) i cili është lëshuar në punë. Në LOT 2 (i financuar nga ECLO), kanë përfunduar afërsisht 95% e punëve, përkatësisht, në ndërtimin e linjave përcjellëse 400kV dhe 110kV. Gjithashtu ka përfunduar edhe projekti 'Zëvendësimi i pajisjeve të tensionit të lartë 400 kV në NS 400/220 kV Kosova B' që ka të bëjë me punë ndërtimore, ngjyrosjen e strukturave metalike dhe instalimin e pajisjeve. Sa i përket ngritjes së kapaciteteve bartëse dhe përmirësimit të infrastrukturës në nivelin 110 kV, ka përfunduar rehabilitimi i linjës së dyfishtë 110kV për Nën Stacionin Lipjan, ndërtimi dhe kyçja në linjën ekzistuese Nën Stacioni Kosovë A - Ferizaj 1 dhe i linjave 110kV të Largpërçuesve 126/4, 179/1, 1801.

2.2.2. REFORMA DHE LIBERALIZIMI I INDUSTRIVETË RRJETIT

Në fushën e aviacionit civil me 13.12.2011 në Ankara, është arritur marrëveshja për shërbimet ajrore midis Republikës së Kosovës dhe Republikës së Turqisë.

Zyra e Rregullatorit për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) gjatë periudhës raportuese ka bërë licencimin e 7 kompanive rajonale publike për grumbullimin e mbeturinave. Poashtu, është nxjerrë Urdhëresa Tarifore për sektorin e ujit dhe furnizuesit e ujit me shumicë. Janë përfunduar Biznes Plani rregullator për sektorin e ujit dhe furnizuesit të ujit me shumicë (sipas kërkesave rregullatore), dhe Plani strategjik i ZRRUM për 2012-2014.

Sa i përket rregullativës së telekomunikacionit, Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) gjatë periudhës raportuese ka miratuar këto tri rregullore:

Rregullorja Nr. 10 për operimin e Njës Shkëmbyese të Internetit, e datës 13.09.2011 (ART Nr. Prot. 046-B-11);

Rregullorja Nr. 11 për të dhënat statistikore periodike të operatorëve, të cilët ofrojnë shërbime telekomunikuese dhe postare, e datës 13.09.2011 (ART Nr. Prot. 048-B-11);

Rregullorja Nr. 12 mbi Procedurat dhe Parimet e Inspektimit të zhvilluara nga Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit, e datës 25.11.2011 (ART Nr. Prot. 065-B-11);

Po ashtu ART përveq UA për Procedurat e Këshillimit me Publikun, ka miratuar vendimin e Bordit të ART-së, të datës 21.11.2011 (ART Nr. Prot. 064-B-11) si dhe 9 vendime me karakter rregullator.

Në kuadër të aktivitetit licencues në periudhën raportuese janë lëshuar tri licenca për ofrimin e shërbimeve telekomunikuese dhe 22 autorizime (licenca individuale) për shfrytëzimin e resurseve frekuencore.

Në nëntor 2011, Grupi Punues i ekspertëve të ART-së në bashkëpunim me ekspertët nga misioni i TAIX-it, ka përfunduar 'analizën e tregut të telefonisë fikse'. Gjithashtu, Bordi i ART-së në mbledhjen e 28-të të mbajtur në datat 15 dhe 17.11.2011 ka miratuar dokumentet për këshillim publik.

Të hyrat nga shërbimet telekomunikuese për tremujorin e tretë të 2011 kanë arritur në €63,718,045.00, e që është një rritje prej rreth 14% në krahasim me tremujorin e dytë të 2011, përkatësisht një rritje prej 5% në krahasim me tremujorin e tretë të 2010. Operatorët e telefonisë mobile dhe fikse, vazhdojnë të zotërojnë pjesën më të madhe të tregut të telekomunikacionit me rreth 90% të të ardhurave. Të hyrat e operatorëve mobil përbëjnë rreth 82.7% të të ardhurave të gjithë tregut, ndërsa operatorët fiks zotërojnë rreth 8.44%.

Lidhur me telefoninë fikse, gjatë tremujorit të tretë të 2011 numri i përdoruesve të telefonisë fikse ka shënuar një rënie prej 2,170 përdoruesish ose 2.4%, ku numri i përdoruesve aktiv vlerësohet të jetë rreth 85,800. Pjesa prej 81,124 i takon operatorit PTK sh.a. Telekomit të Kosovës (TK), ndërsa pjesa tjetër prej 4,681 për operatorin alternativ IPKO.

Lidhur me telefoninë mobile, në fund të tremujorit të tretë të 2011, numri i përdoruesve të telefonisë mobile ka arritur në shifrën prej 1,520,442 përdorues, që paraqet një rritje prej 109,798 përdoruesish ose 7.78% në krahasim me tremujorin paraprak (TM2-2011), përkatësisht është zvogëluar për -1.08% në krahasim me tremujorin e periudhës së njëjtë të vitit paraprak (TM1-2010).

Ndërsa sa i përket shërbimeve të internetit, ka pasur një rritje sa i përket numrit të përdoruesve krahasuar me tremujorin paraprak (TM2-2011). Në tremujorin e tretë të 2011 numri i përdoruesve që kanë qasje në shërbimet e internetit ka arritur në 136,867 linja aktive e cila paraqet një rritje prej 1.06% në krahasim me TM2-2011 përkatësisht është shënuar një rritje e konsiderueshme prej 30% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (TM3-2010).

2.2.3. ZHVENDOSJET STRUKTURE NË EKONOMI

Struktura sektoriale

Sa i përket regjistrimit të ndërmarrjeve të reja nga sektori i bujqësisë, gjuetisë dhe pylltarisë, në tremujorin e tretë të vitit 2011 kemi një rritje prej 72% më të madh të ndërmarrjeve të regjistruara, krahasuar me 2010¹, edhe pse ky ndryshim është relativ. Indeksi total i çmimeve të prodhimeve bujqësore ka rritje për 1.0% në tremujorin e tretë të vitit 2011 krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2010.

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM)

Nuk ka ndryshim nga periudha e fundit raportuese.

Struktura sektoriale e shpërndarjes së NVM-ve

Nuk ka ndryshim nga periudha e fundit raportuese.

¹ Raporti statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike në Kosovë për tremujorin e tretë (T3) 2011, ESK

2.2.4. INTERVENIMET E QEVERISË NË EKONOMI

Ndërmarrjet e mëdha shtetërore

Privatizimi i KKDFE: Në nëntor, Komiteti i Privatizimit ka mbajtur takim në të cilin është bërë shpallja e "Ftesës për Ofertim" për investitorët. Afati i fundit për dorëzim të ofertave pritet të jetë në shkurt 2012, dhe shpallja e fituesit të bëhet në muajin mars 2012.

Privatizimi i PTK: Pasi që nuk ishin plotësuar kushtet për konkurrencë të plotë, Komisioni Qeveritar për Privatizimin e Postës dhe Telekomit (KQP) të Kosovës në tetor 2011, vendosi që të rifillojë procesin e privatizimit të aksioneve të PTK-së. Në nëntor 2011, KQP, në bazë të autorizimeve që ka nga vendimi i Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës, morri vendim që të procedoj me ndarjen e njësisë Posta nga pjesa tjetër e PTK-së. Gjithashtu gjatë këtij takimi është marrë vendim për shpalljen e njoftimit për shprehje të interesit për Këshilltar të Transaksionit. I tërë projekti do të përfundoj në kuartalin e fundit të 2012. Në dhjetor 2011, Qeveria ka marr vendim për ndarjen e njesisë postare nga ndërmarrja publike Posta dhe Telekomit i Kosovës sh.a.

Ndihma shtetërore

Ligji për Ndhimën Shtetërore hyn në fuqi nga janari 2012. Zyra Mbikëqyrëse në kuadër të Komisionit të Konkurrencës është mekanizëm monitorues për ndihmën shtetërore, për këtë zyre është ndarë buxheti për 5 punëtorë për vitin 2012.

Në vitin 2011 janë ndarë subvencione për ndërmarrjet publike në shumë prej €34 milionë, nga të cilat një shumë e konsiderueshme janë dedikuar për KEK-un, dhe pjesa tjetër për ndërmarrjet tjera publike.

2.2.5. INTEGRIMI TREGTAR

Të dhënat statistikore për periudhën janar – tetor 2011 tregojnë se krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, është shënuar një rritje e vlerës së eksporteve dhe importeve, por që Kosova ende është një vend i varur nga importet. Gjatë kësaj periudhe nga Kosova janë eksportuar mallra në vlerë mbi €269 milion, ndërsa janë importuar mallra në vlerë prej €2,006 milion.

Po ashtu gjatë kësaj periudhe eksporti i rregullt është në vlerë prej 44.2% e vlerës së eksporteve të përgjithshme ndërsa pjesa tjetër, apo 55.8% është ri-eksport, kryesisht eksport pas përpunimit të brendshëm. Kjo do të thotë se krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (por duke u bazuar në vlerën e tanishme të eksporteve) kemi një rritje të lehtë të eksporteve të rregullta si dhe një rënie të lehtë të vlerës së ri-eksporteve.

Importet e rregullta përbëjnë 96.9% të importeve, ri-importi përfshinë vlerën prej vetëm 3.1%. Shih tabelën në aneks me të dhënat e përgjithshme për vlerën e eksporteve dhe importeve të Kosovës për periudhën janar – tetor 2010-2011.

3. STANDARDET EVROPIANE

3.1. TREGU I BRENHËM

3.1.1 LËVIZJA E LIRË E MALLRAVE

Për periudhën raportuese sa i përket strukturës legjislative ka pasur një avancim të theksuar duke e pasur parasysh se Ligji për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve është miratuar në Kuvendin e Kosovës me datën 21.12.2011, Ligji për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit është miratuar me datën 31.08.2011.

Standardizim

Nga 4,000 standarde ndërkombëtare dhe Evropiane që janë planifikuar të procedohen deri në fund të vitit 2011, deri më tani numri i standardeve, ka arritur në 3,808 standarde të miratuara si SK (Standarde Kosovare)². Vetëm për periudhën raportuese janë aprovuar 181 standarde të reja. Për periudhën raportuese, AKS ka miratuar 141 standarde nga fusha e teknologjisë informative si dhe 25 standarde nga fusha e transportit dhe shërbimeve postare. Në procedurë janë edhe 61 standarde nga fusha e teknologjisë agroushqimore dhe 21 nga fusha e energjisë.

Me qëllim të promovimit të veprimtarisë së AKS është botuar "Katalogu i Standardeve Kosovare 2011" dhe është organizuar konferenca "Dita Botërore e Standardeve". Në muajin tetor, katalogu u është shpërndarë bizneseve dhe palëve të interesit.

Akreditim dhe Vlerësimi i Komformitetit

Në fushën e Akreditimit dhe Vlerësimit të komformitetit është punuar në akreditimin e disa prej Organeve për Vlerësim të Konformitetit si: Laboratorëve Testues dhe Kalibrues dhe të Organeve Inspektues dhe Certifikues.

Në dhjetor 2011 është akredituar laboratorit për analiza farmaceutike "Trepfarm". Në vazhdim janë kryer procedurat e mbikëqyrjes për Trupa e Vlerësimit të Konformitetit (TVK) si: në tetor 2011, Trupa inspektues tipi A sipas kërkesave të standardit SK ISO/IEC 17020 KPU Inspekt; nëntor 2011, MS Laboratori për analiza të miellit dhe produkteve të tij M&Sillosi Sh.p.k; dhjetor 2011, laboratorit për analiza fiziko-mekanike të betonit dhe produkteve të betonit N.P.N Renelual Tahiri Sh.p.k. sipas kërkesave të standardit SK ISO/IEC 17025. Gjithashtu, janë vlerësuar edhe katër TVK të cilët janë autorizuar sipas UA 16/2011. Deri më tani janë akredituar 19 TVK, dhe se në periudhën raportuese është zgjeruar fusha e akreditimit me një TVK.

Me 06.12.2011 sa i përket funksionalizimit të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë (SMC) sipas kërkesave të standardit SK ISO/IEC 17011 (rishikimi i menaxhimit, auditimi i brendshëm, auditimi i jashtëm i SMC), në Drejtorinë e Akreditimit të Kosovës (DAK), është kryer auditimi i brendshëm dhe i jashtëm dhe janë rishikuar këto dokumente:

- Politika për paanshmëri dhe konflikt të interesit DAK-PO-009;
- Politika për gjurmueshmerinë e matjeve DAK-PO-008;
- Politika për nën-kontraktime DAK-PO-006;
- Politika për testet e zotësisë DAK-PO-007;
- Procedura e menaxhimit për seleksionim;
- Regjistrimi i tre eksperteve teknik DAK-PM-002 procedura për nën-kontraktime DAK-PM-013;
- Procedura për hartimin e certifikatës DAK-PM-014;
- Procedura për pjesëmarrjen në PT-teste DAK-PM-015;
- Manuali i cilësisë DAK-MC-001;
- Rregullorja për punën e këshillit profesional të DAK, DAK-FO-066;
- Rregullorja e komitetit teknik DAK-FO-046;
- Rregullorja e punës së komisionit teknik DAK-FO-063.

² Bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme për Standardizim të Shqipërisë për shfrytëzimin e standardeve të Shqipërisë si standarde kosovare ishte firmosur më 11 prill 2007, kurse aneksi për standardet në format elektronik më 28 shtator 2009.

Më 23 dhe 24 nëntor, në Varshavë të Polonisë u mbajt Asambleja Gjenerale për Bashkëpunim Evropian të Akreditimit (EA) ku në mënyrë ceremoniale DAK nënshkroi kontratën për Anëtar të Asocuar (Associate Member) me EA-në. I gjithë ky dokumentacion i procedurave të akreditimit i rishikuar i është dërguar EA-së dhe se tani është pranuar një përgjigje.

Gjatë periudhës raportuese në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të DAK janë organizuar disa trajnime sipas kërkesave të standardit EN ISO 17024, dhe të PTB Gjermanet (Insituti nacional shtetëror për metrologji) sipas rregullorës ku si tema të trajnimit ishin:

Prezantimi i EN 45011 dhe principet e certifikimit të produktit;

Kërkesat gjenerale dhe të veçanta të ISO/IEC Guide 65/EN 45011 (teori/shembuj);

Standardi i ri ISO/17065, akreditimi i trupave certifikuese;

Drafti i ri për ISO/IEC ISO 17065 dhe 17067 dhe aplikimi i tyre në skema të ndryshme certifikimi;

Kombinimi me standarde të tjera si ISO 17025, 17020 dhe ISO 17021 për certifikim të produktit;

EA 2/17, udhëzues i kërkesave për akreditimin e TVK-ve për notifikim dhe e direktivave të qasjes së re.

Sa i përket Mbrojtjes së Konsumatorit është vazhduar me Implementimin e Programit Kosovar për Mbrojtjen e Konsumatorit, ku gjate periudhës raportuese janë mbajtur dy takime të këshillit për mbrojtjen e konsumatoreve. Në këtë drejtim me 11.12.2011 dhe 21.12.2011 janë organizuar dy punëtori me kategori të ndryshme të konsumatoreve (nxënës dhe student). Po ashtu me 20.12.2011 është bërë spoti televiziv për promovimin e numrit për mbrojtjen konsumatorit i cili do të filloj të emetohet nga janarit i vitit 2012. Vlen të theksohet se Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorit tanimë është ndarë nga Departamenti i Tregtisë dhe është vendosur pranë Zyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë si zyre e pavarur.

Me 14.12.2011, është bërë pranimi teknik i objektit për laboratorin e industrisë kimike i cili mundëson funksionalizimin e Laboratorëve për Vlerësimin e Konformitetit të produkteve industriale. Gjithashtu me 20.12.2011 është përfunduar ndërtimi i objektit të Institutit për Produktet e Ndërtimit (IPN).

Ne fushën e turizmit është bërë inaugurimi formal i softuerit për regjistrimin e mysafirëve nga objektet e akomodimet nga muaji tetor i këtij viti 2011. Nga muaji janar i vitit 2012 të gjitha subjektet e akomodimit janë të obliguara të përcjellin të dhënat mbi numrin e vizitorëve.

Gjatë periudhës raportuese për fushën e Metrologjisë vlenë të përmendet se Laboratori për madhësi elektrike është pajisur me etalon për matjen e energjisë elektrike, si dhe është bërë trajnimi i stafit për atë. Gjithashtu janë hartuar procedurat për akreditimin e dy laboratorëve: Laboratorit të masës, dhe vëllimit; si dhe të atij të rrjedhjes.

3.1.2. LËVIZJA E LIRË E KAPITALIT

Në tetor 2011, është funksionalizuar Korniza e Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik, si pjesë e Fuqizimit të mbikëqyrjes së bazuar në risk.

Në shtator 2011, në fushën e zhvillimit të sistemeve ndërbankare bashkëkohore për ofrimin e shërbimeve bankare efektive për klientë, është finalizuar ToRs për sistemin e shlyerjes individuale të pagesave në kohë reale. Në nëntor 2011 në bashkëpunim me BB, është krijuar njëسيا për politikat dhe rregullat e vendosura për mbikëqyrjen e sistemit të pagesave në Kosovë. Ne dhjetor 2011 është finalizuar ToRs lidhur me automatizimin e procesit të inicimit të transaksioneve dhe marrjes së informacionet nga ana e klientëve të BQK-së në bashkëpunim me USAID dhe BEEP.

Lidhur me Bashkëpunimin ndër-bankar është bërë Standardi GDDS (General Data Dissemination Standard) i cili vazhdon të mbetet si raportimi i rregullt mujor. Ndërsa në nëntor është funksionalizuar Komitetit Nacional për GDDS, si dhe njëسيا për letra me vlerë.

3.1.3. DOGANAT DHETATIMET

a. Doganat

Në kuadër të zbatimit të ligjit për masa doganore dhe për mbrojtjen e të drejtës së Pronësisë Intelektuale, janë ndërmarrë masa konkrete si: 3 aplikacione janë pranuar për mbrojtje të markës tregtare; janë zbuluar 340 artikuj për të cilat është dyshuar se shkelin pronësinë intelektuale, ku për 323 artikuj është pranuar konfirmimi nga bartësi i së drejtës, se shkelin pronësinë intelektuale.

Gjatë kësaj periudhe në kuadër të Task Forcës (raste nga Dogana, bashkëpunim në mes të Doganës dhe Policisë dhe raste të referuara nga Policia e Kosovës) janë zhvilluar 73 raste të konfiskimit të mallrave, vlera e të cilave është mbi 110,000 Euro. Dënimet e shqiptuara për këto raste janë 47,000 Euro.

Në luftën kundër kontrabandës dhe krimit të organizuar janë iniciuar 7 kallëzime penale që kapin vlerën e evazionit fiskal rreth 800,000 Euro. Stafi është duke u zhvilluar sipas Kornizës së Planifikimit Afatmesëm të Trajnimeve. Gjatë muajit nëntor dhe dhjetor janë mbajtur 5 trajnime: Teknikat e Hetimit Financiar, Zyret për Ruajtjen e Aseteve, Lufta Kundër Korrupsionit, Terrorizmi Global, Rëndësia e Inteligjencës, Trajnim i Avancuar për Armë të Shkatërrimit në Masë Kriminale në Luftimin e Terrorizmit Global. Në këto trajnime kanë marrë pjesë 21 zyrtar doganor. Trajnimi i 13 zyrtarëve ka përfunduar, ndërsa është në proces përgatitja e prototipit preliminar të ASYCUDA-së në Doganë.

b. Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)

ATK gjatë periudhës raportuese ka lëshuar 2010 numra fiskal, 1756 biznese janë pajisur me arka fiskale si dhe janë instaluar 1814 arka fiskale. Njësia për Hetime Tatimore, është funksionalizuar dhe gjatë periudhës raportuese janë trajtuar 15 raste.

Në kuadër të ngritjes së sistemit SIGTAS, krahas moduleve kryesore të aplikacionit, janë aktivizuar edhe këto module: Moduli i Mbledhjes së Detyrueshme, Moduli i Kontrollit, Moduli i Ankesave. Është funksionalizuar moduli i Qendrës së Thirrjeve si dhe janë krijuar Analistet e Biznesit.

Në kuadër të bashkëpunimit me Prokurorinë, janë caktuar 6 Prokuror Rajonal, nga Prokuroritë (Prishtinë, Pejë, Gjiilan, Prizren, Ferizaj dhe Mitrovicë).

Për periudhën 1 shtator - 20 dhjetor 2011 janë mbajtur gjithsej 26 trajnime në lëmi të ndryshme si: zbatimi i legjislacionit tatimor, metodat e vlerësimit të stafit (performanca), aftësitë e prezantimit, procedurat e qendrës së thirrjeve, ku kanë marr pjesë 361 pjesëmarrës. Në këto trajnime kanë marr pjesë edhe 36 inspektor të rinj.

Gjatë periudhës raportuese janë organizuar 10 Seminare dhe 8 tryeza të rrumbullakëta. Qëllimi i këtyre seminareve dhe tryezave ka qenë informimi lidhur me zbatimin e legjislacionit tatimor, ngritja e shërbimit ndaj tatimpagueseve si dhe diskutimi i shqetësimeve të tatimpaguesve.

Në ofrimin e shërbimeve elektronike gjatë kësaj periudhe raportuese janë shkarkuar 326,064 deklarata sipas llojeve të ndryshme të tatimeve. Ndërsa 163 biznese kanë deklaruar on-line.

3.1.4. KONKURRENCA

Gjatë periudhës raportuese janë kryer hetimet në të gjitha bankat në Kosovë, ku janë gjetur një mori shkeljesh të ligjit mbi konkurrencën, veçanërisht janë gjetur shkelje që kanë të bëjnë me Normat e Interesit të Bankave (marrëveshje e koordinuar) dhe se të gjitha lëndët e hulumtuara janë të gatshme për t'u zbatuar. Priten të ndermirën masa pasi që të kompletohet autoriteti i konkurrencës me staf, ngase dy anëtarëve e bordit u ka skaduar mandati.

3.1.5. PROKURIMI PUBLIK

Ligji i ri për Prokurim Publik Nr. 04/L-042, ka hyrë në fuqi më 05.10.2011, KRPP-ja në bashkëpunim me Ekipin e Projektit të financuar nga ZNKE deri më 31.12.2011 ka finalizuar dhe shpallur 60 pjesë të legjislacionit dytësor për prokurim publik, të cilat kanë hyrë në fuqi nga 01.01.2012. Këto pjesë të legjislacionit dytësor të zyrtarizuara përbejnë 80 % të tërë legjislacionit dytësor të nevojshëm për implementimin e Ligjit për prokurim publik. Nga periudha 01.09.2011 e deri më 23.12.2011, janë

përfunduar monitorime në 14 Autoritete si monitorime të rregullta dhe 1 monitorim sipas rastit. Janë përfunduar 60 monitorime me qëllim të përmirësimit të njoftimeve të publikuara, të autoriteteve kontraktuese, në Ueb faqen e KRPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) ka pranuar gjithsejtë 167 ankesa të operatoreve ekonomik përfshirë edhe kërkesat e Autoriteteve Kontraktues për rishqyrtimin e vendimeve të APP-së. Prej tyre 155 ankesa janë të operatoreve ekonomik të ushtruara kundër vendimeve të autoritetit kontraktues për dhënien e kontratës, kurse 12 janë kërkesa për revokim të nenit 32 pikë 5 të ligjit për prokurim publik. Prej 155 ankesave të OE, 127 janë shqyrtuara nga OSHP-ja, kurse 28 janë në shqyrtim e sipër. Ndërsa 47% të ankesave kanë shkuar në favor të operatorëve ekonomik. Kurse sa i përket kërkesave të AK-së për revokim të nenit 32.5 të ligjit, janë shqyrtuar 12 kërkesa, në favor të Autoriteteve Kontraktues kanë shkuar 74%.

3.1.6. TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE DHETË DREJTAT E AUTORIT

Me datë 16.09.2013 me vendim është formuar Këshilli për Pronësinë Industriale dhe në mbledhjen e parë të Këshillit të datës 03.11.2011 është miratuar statuti për funksionimin e Këshillit të Pronësisë Intelktuale. Gjithashtu nga ZPI janë publikuar 5 numra të rinj të Buletinit Zyrtar me objektiva të regjistruara të pronësisë industriale.

3.1.7. PUNËSIMI DHE POLITIKAT SOCIALE

Gjatë periudhës raportuese në bazë të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, janë hartuar dhe aprovuar nga qeveria këto udhëzime administrative:

UA nr. 11-2011 për sistemimin e punëve të rënda dhe të rrezikshme të cilat dëmtojnë rëndë shëndetin e grave shtatzëna dhe gji-dhënëse, 14.11.2011;

UA nr.12/2011 për regjistrimin e marrëveshjeve kolektive me 30.11.2011.

Gjatë vitit 2011 në funksion të ngritjes së nivelit të bashkëpunimit administrativ me datën 17.10.2011 në Minhen u mbajti takim në mes zyrtareve të MPMS të Republikës së Kosovës dhe Institutit të Sigurimit Pensional të Bajernit Jugor në Gjermanisë

Për zhvillimin e negociatave në mes të Republikës së Kosovës me shtetet e rajonit dhe të BE-së në fushën e Marrëveshjeve Bilaterale për sigurime shoqërore - Sigurimit Pensional e Invalidor, Departamenti i Punës dhe Punësimit ka bashkëpunuar me Departamentin e Mirëqenies Sociale për integrimin e përfituesve të asistencës sociale, ka ndërmjetësuar në punësim rreth 460 përfitues, që janë shfrytëzues të Asistencës Sociale të kategorisë së dytë nëpërmjet Programit të Punëve Publike/Kosova 2011 i financuar nga BB.

Përmes Programit Kosova e Bukur "EU - Beautiful Kosova" nga të 7 projektet e implementuara deri tani janë punësuar 163 punëkërkuar, të rekrutuar nga Qendrat për punësim. Qëllimi i këtyre programeve është punësimi intensiv afatshkurtër.

Përmes projektit Mbështetje MPMS-së nga BE-ja, janë zhvilluar trajnimet me 4 pilot komunat të cilat kanë përfutuar në hartimin e Planeve të Punës për vitin 2012.

Më 14.11.2011 me mbështetje të projektit të financuar nga DIFID-I dhe në pajtim me ZNKE, MPMS ka organizuar konferencën "Sfidat dhe Mundësitë e Decentralizimit të Shërbimeve Sociale" në të cilën konferencë kanë marrë pjesë përfaqësues të Ministrive, Komunave, Shoqërisë Civile, Universitetit etj.

Sa i përket sektorit të Shëndetësisë gjatë muajit dhjetor në të gjitha institucionet shëndetësore është funksionalizuar Moduli i Sistemit të Informimit Shëndetësor (SISh) dhe Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Stokut Farmaceutik (SEMSF).

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve në sektorin e Shëndetësisë gjate periudhës raportuese janë trajnuar 80 punëtor shëndetësor për menaxhimin e emergjencave.

Për ofrimin e shërbimeve shëndetësore në të gjitha komunitetet minoritare me prioritet të veçantë komuniteti RAE janë ndërmarr këto veprime: është bërë raporti vlerësues mbi shkallën e kontaminimit

ku fillimisht është përfunduar por për shkak të specifikës së kontaminimit ky raport përditësohet sipas vlerave të gjetura në terren. Deri tani janë marrë 270 mostra si nga gjaku kapilar po ashtu edhe nga ai venoz ndërsa për fëmijët në trajtim mirën analizat laboratorike për përcjelljen gjatë trajtimit. Në trajtim janë 9 fëmijë nga lokaliteti i Mëhallës së Romëve si dhe një person nga Komuna e Gjilanit, gjithashtu janë siguruar barna me sasi të mjaftueshme për trajtimin e personave me nivele të ngritura të plumbit në gjak.

3.1.8. ARSIMI DHE HULUMTIMI

Gjatë periudhës raportuese shtator - dhjetor 2011 janë miratuar një numër i udhëzimeve administrative³. Pas miratimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK) 2011 - 2016 MASHT ka themeluar organet që do të mbikëqyrin dhe analizojnë zbatimin e PSAK-ut, duke përfshirë grupin teknik strategjik, sekretariatit e PSAK-ut dhe komitetin drejtues. MASHT po ashtu ka hartuar Planin e Veprimit për vitin 2012 i cili është i bazuar në PSAK.

Kanë përfunduar punimet në katër objekte shkollorë dhe janë pajisur me inventarin e nevojshëm shkollorë. Dyzet (40) institucione të arsimit parauniversitar duke përfshirë edhe

tri (3) shkolla për fëmijët me nevoja të veçanta, janë pajisur me kabinete të TIK-ut dhe më se 2300 mësimdhënës dhe burime tjera njerëzore të angazhuara në procesin arsimor janë trajnuar për aplikimin e TIK-ut në sistemin arsimor. Është themeluar portali nacional i edukimit, ku janë publikuar përmbajtjet elektronike në të gjitha gjuhët e komuniteteve.

Shumica e teksteve shkollorë në gjuhën e komuniteteve janë siguruar. Në muajin nëntor 2011 për herë të parë është botuar libri i gjuhës shqipe për nxënësit e komuniteteve jo shqiptare. Është punësuar një mësimdhënës për gjuhën rome dhe janë punësuar disa mësimdhënës në mësimin e gjuhës boshnjake dhe turke sipas nevojave.

Ka vazhduar krijimi i kushteve adekuate për fëmijët me nevoja të veçanta. Gjatë muajve shtator - dhjetor 2011 janë trajnuar 200 mësimdhënës sipas moduleve të ndryshme për arsimin gjithëpërfshirës.

Gjatë muajit nëntor dhe dhjetor 2011 janë mbajtur dy sesione informuese rreth programeve të ndryshme kërkimore si Programi i IPA-s "Ndërtimi i Kapaciteteve Kërkimore" dhe konferencë informative për programin e 7 të kornizës së BE-së për Kërkime Shkencore dhe Zhvillim të Teknologjisë-FP7. Është hapur thirrja për aplikim në programin "Join EU - SEE" të Erasmus Mundus.

Ka vazhduar zbatimin e programit të trajnimit dhe licencimit të mësimdhënësve të arsimit parauniversitar. Gjatë muajit nëntor 2011 janë akredituar 5 programe të reja për trajnimin e mësimdhënësve. Është hartuar dhe përkthyer katalogu i programeve të trajnimit nga SWAP-i, në gjuhën angleze dhe serbe si dhe në fund të muajit dhjetor 2011 ka dal nga shtypi. Gjatë vitit 2011 janë trajnuar mbi 10.000 mësimdhënës në programin ECDL dhe në programin AKM (Avancimi i Kualifikimeve të Mësimdhënësve).

3.2. POLITIKAT SEKTORIALE

3.2.1. INDUSTRIJA DHE NVM-TË

Gjatë muajit nëntor 2011, në Prishtinë, Delegacioni i Komisionit Evropian, Drejtorati Gjeneral për Ndërmarrësi dhe përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse të Qeverisë së Republikës së Kosovës kanë realizuar takimin bilateral për "Vlerësimin e progresit të Aktit Evropian për biznese të vogla". Takimi u organizua nga Agjencia për mbështetjen e NVM-ve/MTI në bashkëpunim me Fondacionin Evropian për Trajnime (FET). Me këtë rast është raportuar për progresin e bërë në 10 dimensionet e EU - SBA nga raporti i progresit për EU - SAB i përgatitur më herët nga Agjencia për Mbështetjen e Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (AMNVM).

³ UA për licencimi dhe regjistrimi i institucioneve edukative-arsimore parashkollorë private, nr. 6/2011, datë 14.09.2011;
UA për krijimi dhe fuqizimi i ekupeve për parandalimin dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit në arsimin e obliguar, nr. 7/2011, datë 14.10.2011;
UA për institutin pedagogjik të Kosovës, nr. 08/2011, datë 14.10.2011;
UA për kodin e Etikës për Vlerësimin e nxënësve, nr. 491/01, datë 23.12.2012;

Nga 17 nëntori dhe deri më 06 dhjetor është implementuar projekti "Ditët e Biznesit të Vogël" që është organizuar nga AMNVM në partneritet me pesëmbëdhjetë partnerë të ndryshëm (ECLD, Swiss Development Agency, SPARK, OEK, AKB, AMCHAM, RDA – 5, ATK, Doganat e Kosovës, Trusti). Qëllimet kryesore të projektit ishin: promovimi i konceptit të ndërmarrësish, NVM më të suksesshme në nivel regjional dhe nacional si dhe shpërblimi i tyre, si dhe fuqizimin e dialogut publiko-privat. Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur shtatë (7) konferenca, një panair tre (3) ditor, një lojë shpërblyese për grupmoshat 18 – 25 për idenë e biznesit më konkurruese. Ky projekt është i pari i llojit të tij i organizuar në Kosovë dhe është plotësisht i njëjtë me projektin "EU SME Week" organizuar në kuadër të KE-së.

Në tetor është mbajtur tryeza e rrumbullakët e organizuar nga AMNVM, në mes të OECD dhe institucioneve qeveritare dhe jo-qeveritare si dhe sektorit privat, ku bashkërisht janë diskutuar njëzetekatër (24) projekt propozime. Në vazhdim nga këto është përzgjedhur një (1) i cili do të implementohet në Kosovë. Projekti i përzgjedhur ka të bëjë me "Hartimin e strategjisë mbi inovacionet" i cili mbështetet nga KE dhe implementohet përmes OECD.

Në drejtim të Promovimit të Kosovës si vend i përshtatshëm për investime është organizuar promovimi në Wall Street Summit Event në New York, ShBA më 09 - 16.12.2011; në Romë, Itali më 28 - 30.11.2011; në Bruksel - Belgjikë më 30 - 02.12.2011; në Paris - France më 23-25.11.2011; në Cyrih - Zvicër më 15 - 17.11.2011; në Vjenë - Austri "Vienna Economic Talks - Meet Kosovo in Vienna" më 23 - 26.10.2011; në Zagreb - Kroaci më 18 - 19.10.2011; si dhe pjesëmarrja në South East European Centre for Entrepreneurial Learning (SEECEL).

Sa i përket performancës së Agjencisë për Promovimin e Investimeve në Kosovë (APIK), duke filluar prej datës 31 tetor deri më 2 nëntor 2011 është organizuar trajnimi nga zyra e ECIKIST në Vjen, për mënyrën e përdorimit të softuerit CRM ACT 2011. Me datën 12 deri më 16.12.2011 dy zyrtar të APIK-ut kanë marr pjesë në Punëtorinë "Reduktimi i Pengesave Administrative në Administratën Publike" në Danilovgrad, Malit të Zi. Si rezultat i pjesëmarrjes në panair jashtë dhe brenda vendit është zgjedhur kompania më potenciale Eksportuese dhe se APIK-u ka bërë përzgjedhjen e "Eksportuesit e vitit 2011" në ceremoninë e zgjedhjes, të mbajtur me datë 21.12.2011.

Agjencia për Promovimin e Investimeve

3.2.2 BUJQËSIA DHE PESHKATARIA

Gjatë kësaj periudhe raportuese, janë miratuar dy udhëzime administrative:

UANr.05.2011 "Për Kushtet dhe Mënyrat e Gjuetisë", 09.09.2011;

UANr.07.2011 "Regjistrimin e fermerëve", 25.08.2011.

Më datë 09.09.2011, MBPZHR ka dhënë dy pëlqime për vend gjueti të përbashkëta, që të dyja në Malishevë, nr.273/3.

Sa i përket rehabilitimit të sistemit të ujitjes gjatë kësaj periudhe janë ndërtuar 4 penda dhe janë rregulluar katër kanale të ujitjes të cilat janë paraqitur në tabelën 1 dhe 2.

Tabela 4: Ndërtimi i pendëve

Nr.	Vendi i ndërtimit të pendëve	Sipërfaqja e ujitur/ha
1	Broliq-Pejë	300
2	Brovinë-Gjakovë	250
3	Metehi	90
4	Mrasor	86
	Gjithsejtë:	932 ha.

Tabela 5: Rregullimi i kanaleve të ujitjes

Nr.	Vendi i rregullimit të kanaleve	Gjatësia/m	Sipërfaqja e ujitur/ha
1	Mushitisht- Suharekë	3733	800
2	Poslisht-Prizren	2500	550
3	Gështenjë	1828	1000
4	Junik	1996	1000
5	Soponicë-Nikë-Kaçanik	2746	900
	Gjithsejtë:	12,903m	4,250 ha.

Është bërë rregullimi i stacionit të pompave në fshatin Pantinë të komunës së Vushtrrisë për ujitjen e 900 ha. si dhe janë hartuar 23 projekte për të gjitha akumulimet e vogla të ujit (të mundshme) në territorin e Kosovës. Me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës për ujitje, Kompanitë e Ujitjes "Radoniqi" dhe "Dukagjini" janë furnizuar me pjesë rezervë në vlerë prej 49,916.31 €.

Me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të politikave bujqësore dhe zhvillim rural, MBZHRP ka miratuar programin vjetor për bujqësi dhe zhvillim rural për vitin 2012.

Në sistemin e informacionit për parcelat e tokës përmes projektit "Land Parcel Information System" janë vendosur 28,996 ha. në 35 komuna të Kosovës.

Në këtë periudhë raportuese janë pyllëzuar 350 ha. Janë lëshuar 8 kontrata të punës dhe 8 pëlqime për operator ekonomik (gurthyesh). Për dëmtues të pyjeve janë lëshuar 1,824 fletëparaqitje, prej të cilave, 1,020 fletëparaqitje janë për kundërvajtje dhe 804 fletëparaqitje penale.

Agjencioni Pyjor i Kosovës (APK) ka hartuar planet menaxhuese për 32,307 ha, ndërsa Projekti Norvegjez (NFG) ka hartuar planet menaxhuese për 14,039 ha.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve njerëzore, më 20.10.2011, në komunën e Vushtrrisë, është mbajtur një trajnim për përdorimin e preparateve kimike. Në trajnim kanë marr pjesë 29 fermer dhe shitës të produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Siguria e Ushqimit dhe Veterinaria

Sa i përket organizimit unik të inspektorëve kufitarë, komunal dhe qendrorë për gjithë territorin e Kosovës, AUVK ka rinovuar dhe adaptuar katër (4) objekte në bashkëpunim me organet komunale (Komunën e Pejës, Gjilanit, Prizrenit dhe Komunën e Mitrovicës).

Më 30.09.2011 Qeveria e Kosovës ka miratuar 4 Rregullore për "Pakon Higjienike të Ushqimit":

Rregullorja nr. 10-2011: "Për kontrollet Zyrtare për verifikimin e përputhshmërisë së ligjit të Ushqimit dhe Ushqimit për kafshë dhe rregullave për Shëndetin dhe Mirëqenien e kafshëve", Rregullorja e KE-së 882-2004;

Rregullorja nr. 11-2011 "Për Higjienën e Prodhimeve Ushqimore", Rregullorja e KE 852-2004; Rregullorja nr. 12-2011 "Për Përcaktimin e rregullave Specifike të Higjienës së Ushqimit me Prejardhje Shtazore", Rregullorja e KE 853-2004;

Rregullorja nr. 13-2011 "Për Caktimin e rregullave Specifike për Organizimin e kontrolleve Zyrtare të Ushqimit me prejardhje Shtazore të dedikuara për konsum nga Njerëzit", Rregullorja e KE 854-2004.

Në këtë periudhë është bërë identifikimi dhe regjistrimi (I&R) i 51419 gjedheve të rinj, ndërsa në bazën e të dhënave veterinarë të kontraktuar kanë raportuar 51 685 lindje të këtyre kafshëve. Gjatë kësaj periudhe ka përfunduar identifikimi dhe regjistrimi i 178,254 ruminantëve të vegjël.

Më 22.12.2011 janë nënshkruar Procedurat Standarde të Operimit (PSO) për konfiskimin e kafshëve të kontrabanduara.

Nga të gjitha kafshët e përzgjedhura nga ana e sektorit të shëndetit të kafshëve për vaksinim dhe testet e TBC për këtë periudhë raportuese, janë raportuar 22 mijë krerë në bazën e të dhënave të sektorit të identifikimi dhe regjistrimi (I&R). Bazuar në Ligjin e Ushqimit dhe Rregulloretë të "Pakos Higjienike të Ushqimit", janë aprovuar 18 depo ftohëse të ushqimit me prejardhje shtazore.

3.2.3 Mjedisi

Si rrjedhojë e procesit të plotësimit të kornizës ligjore, MMPH ka miratuar këto ligje:

Projektligjin për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore, 21.12.2011;

Projektligjin për Parkun Kombëtar "Sharri";

Projektligjin për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna".

Po ashtu MMPH me datë 14.12.2011, ka miratuar UA për normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga burimet e lëvizshme.

Me qëllim të përmirësimit të politikave sektoriale, MMPH ka miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Biodiversitetin me datë 10.10.2011.

Në kuadër të intensifikimit të aktiviteteve për mbrojtje të mjedisit dhe planifikimit hapësinor, është prezantuar Udhëzuesi për hartimin e Programeve 3 vjeçare të banimit nëpër komunën e Gjilanit, Pejës, Prizrenit, Prishtinës dhe Mitrovicës përmes 5 punëtorive, ku kanë marrë pjesë 150 zyrtarë të këtyre komunave që merren me këtë fushë.

Sa i përket procesit të ndërtimit të impianteve për sterilizimin e mbeturinave infektive, është ndërtuar dhe funksionalizuar impianti në Gjakovë. Gjithsej janë 6 impiante të ndërtuara, dhe pajisur me pajisje për sterilizimin e mbeturinave infektive spitalore dhe funksionale.

Për më tepër, në vijën e angazhimeve për krijimin e rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit janë funksionalizuar edhe 4 stacione monitoruese për cilësinë e ajrit. Deri më tani janë funksionalizuar gjithsej 9 stacione.

Në vazhden e ngritjes së kapaciteteve njerëzore, janë mbajtur tri punëtori në kuadër të Projektit RENA në Kroaci mbi Monitorimin, Raportimin dhe Verifikimin - sistemi i BE-së i tregtimit me emisione, ku kanë marrë pjesë 3 zyrtarë nga MMPH; punëtorja për Hartimin e Strategjisë Mjedisore për përafrim ku kanë marrë pjesë 20 zyrtar nga MMPH dhe punëtorja me temën Emisionet e gazrave serë, në Tiranë ku kanë marrë pjesë 4 zyrtarë të MMPH-së.

3.2.4. POLITIKAT E TRANSPORTIT

Në kuadër të përafrimit dhe fuqizimit të legjislacionit primar, më 14.11.2011 është miratuar Ligji për Hekurudhat e Kosovës.

Sa i përket implementimit të projektit të R7, është përfunduar dhe hapur për qarkullim segmenti 1 - 4b (38 Km). Gjithashtu, ka përfunduar projekti zbatues për segmentin 5 (Qafa e Dulës - Udhëkryqi M9 Gjurgjicë). Për më tepër, janë hapur punimet në segmentin e pestë në gjatësi prej 15 kilometrave (8km trasesë është hapur).

Ka hyrë në fuqi Rregullorja 9-2011 e AAC-së mbi vlerësimin e sigurisë së aeroplanëve të huaj, kualifikimet e inspekteve dhe listën e kompanive ajrore të ndaluara në RKS. Kjo Rregullore transponon katër Rregullore të BE-së të përfshira në Marrëveshjen ECAA (EC Reg. no 768-2006, EC Reg. no 2111-2005, EC Reg. no 473-2006 dhe EC Reg. no 474-2006).

Në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar, përkatësisht në arritjen e marrëveshjeve bilaterale mbi transportin e udhëtareve dhe mallrave, janë nënshkruar marrëveshjet me Austrinë, Kroacinë.

Në vazhden e implementimit të ligjit mbi transportin e mallrave të rrezikshme, 10 automjete janë certifikuar për transport të mallrave të rrezikshme - ADR, ndërsa janë licencuar 7 operatorë të transportit të mallrave të rrezikshme.

Me qëllim të vendosjes së linjave të rregullta në transportin e rregullt të udhëtarëve me autobus me vendet e rajonit dhe më gjerë, janë lëshuar 13 leje operatorëve vendor dhe 17 leje operatorëve të huaj për operim në Kosovë. Në avancim të përpjekjeve për përmirësimin e kualitetit të rrjetit ekzistues të

transportit rrugor ndër-urban, janë pajisur me licencë tetëmbëdhjetë operatorë të transportit të udhëtarëve.

Në drejtim të implementimit të programit për siguri në komunikacionin rrugor, me 23.11.2011 është mbajtur takimi ndërministror i Këshillit për Siguri në Komunikacionin Rrugor. Gjithashtu, ka përfunduar fushata vetëdijesuese për siguri rrugore, me ç'rast janë shpërndarë 60 mijë fletë palosje dhe 10 mijë pano reklamuese në regjionin e Pejës, Prizrenit dhe Gjakovës.

Më tej, në kuadër të zbatimit të programit të mirëmbajtjes dhe rehabilitimit kanë përfunduar në tërësi 30 km rrugë rajonale dhe 85.4 km rrugë lokale, ndërkaq në segmente përkatëse punimet janë duke rrjedhur si në vijim:

Segmenti M9 Sllatinë – Gjurgjicë – realizimi i përgjithshëm i projektit është 93% (gjatë kësaj periudhe 10%) ndërkaq objektet 91% (gjatë kësaj periudhe 6%);

Segmenti M2 Shkabaj – Milloshevë, realizimi i përgjithshëm i projektit është 90% (gjatë kësaj periudhe 9%).

Sa i përket trajnimeve profesionale, në fushën e transportit të mallrave të rrezikshme janë trajnuar dhe certifikuar 92 shofer.

Gjatë muajit nëntor, ekspertë nga Komisioni Evropian ndërmorën një vizitë vlerësuese për të parë nivelin e zbatimit të Marrëveshjes ECAA në Kosovë. Me këtë rast ata vlerësuan institucionet publike me përgjegjësi në aviacionin civil (AAC-në, MI-në, MPB-në dhe Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Ajrore) si dhe Autoritetin për mbrojtjen e konkurrencës, MPMS në lidhje me ligjin e punës dhe MF-në në lidhje me ligjin për ndihma shtetërore. Bazuar në rezultatet preliminare të Komitetit Drejtues të marrëveshjes, dhjetor 2011, Kosova është raportuar të ketë përmbushur të gjitha obligimet që dalin nga faza e parë e kësaj marrëveshje. Raporti i vlerësimit final pritet në tremujorin e parë të vitit 2012.

3.2.5. ENERGJIA

Me qëllim të zbatimit të Ligjit Nr.03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, MZHE ka miratuar:

Rregulloren Nr.04-2011 për Trajtimin e Komunitetit në Sektorin Minerar, 27.10.2011;

Rregulloren Nr. 05-2011 për Organizimin dhe Funksionimin e Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve, 14.11.2011;

Rregulloren Nr.06-2011 për Sigurinë Minerare, 23.11.2011.

Me qëllim të zbatimit të Ligjit nr. 03-L-184 për Energjinë, MZHE ka miratuar: UA nr. 07-2011 mbi Rregullat për Balancat e Energjisë, 15.12.2011.

Me qëllim të zbatimit të Ligjit nr. 04-L-016 për Efiçencën e Energjisë, MZHE ka miratuar Rregulloren nr. 08-2011 për themelimin e Agjencisë së Kosovës për Efiçencë të Energjisë, 15.12.2011. Në dhjetor 2011 MZHE ka zgjedhur këshilltarët e Transaksionit për ofrimin e shërbimeve të konsulencës rreth përgatitjes së dosjes së tenderit për Termocentralin Kosova e Re, me qëllim të zgjedhjes së investitorit.

Në kuadër të projektit të KE-së për zbatimin e masave të efiçencës së energjisë në ndërtesa publike – shkolla dhe spitale, tashmë janë identifikuar rreth 65 shkolla dhe spitale (klinika) në të cilat është kryer edhe procesi i auditimit energjetik me qëllim të identifikimit të potencialit për kursim, llojin e masave që duhet të ndërmerren si dhe kostoja financiare e tyre.

Në fushën e përfundimit dhe rehabilitimit të infrastrukturës së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, KEK ka lëshuar në punë dy Trafo Stacione (TS):

NS Skenderaj 110/10(20) kV, 1 x 31.5 MVA dhe

NS Prishtina 1, 110/10(20) kV, 1 x 63 MVA;

Ndërsa është rritur fuqia në:

NS Peja 1, 110/35 kV, 1 x 40 MVA (është ndërruar TR 20 MVA në 40 MVA) dhe
NS Prishtina 3, 110/35 kV, 1 x 40 MVA (është ndërruar TR 31,5 në 40 MVA).

KOSTT sh.a. duke synuar në përmirësimin e cilësisë dhe ngritjen e kapaciteteve transmetuese dhe transformuese në Rrjetin e Transmisionit 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, me sukses ka përmbyllur implementimin e projekteve me ndikim në ngritjen e kapaciteteve, rritjen e sigurisë së operimit dhe furnizimit me energji elektrike, me çka edhe ka avancuar plotësimin e kriterëve nga ENTSO-E. Në kuadër të këtyre, KOSTT ka implementuar:

Paket Projektin 400/110 kV/kV Ferizaj 2 (përveq linjës NS Ferizaj 2 - NS Gjilan 5),
Zëvendësimin e pajisjeve të tensionit të lartë në NS 400/220 kV Kosova B
Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve në rrjetin 110 kV: LP 126-4, LP 179-1, LP 1801.

Lidhur me zhvillimin e tregut të energjisë elektrike, në dhjetor 2011, KOSTT ka përfunduar instalimin e hardverit dhe softverit për Sistemin TI për Operatorin e Tregut.

3.2.6. SHOQËRIA INFORMATIVE DHE MEDIA

Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit (ART) me miratimin e rregulloreve⁴ ka harmonizuar legjislacionin sekondar me paketën 2003 - 2009 të Komisionit Evropian.

3.2.7. KONTROLI FINANCIAR

Në kuadër të përmirësimit të legjislacionit për menaxhimin e aseteve publike, Ligji për Partneritetin Publiko-Privat ka hyrë në fuqi me 11.12.2011.

Në shtator të 2011 është azhurnuar dhe publikuar Doracaku për Auditimin e Brendshëm dhe standardet e Auditimit të brendshëm në të tri gjuhët zyrtare.

Është vazhduar me azhurnimin e listës së projekteve si në nivel qendror ashtu dhe atë komunal: a) Është aprovuar projekti PPP nga Komuna e Pejës: "Shërbimet e Transportit Urban në Komunën e Pejës". b) Është dorëzuar për aprovim projekti PPP nga Komuna e Suharekës "Shërbimet Komunale të Mbeturave në Komunën e Suharekës"

Në kuadër të promovimit të projekteve të PPP janë zhvilluar takime informuese: 1 tryezë e rrumbullakët me 18.10.2011 në Prishtinë; 7 Takime informuese Viti (11.11.2011), Prizren (2 herë), Suharekë (tri herë); MSh (21.12.2011). Po ashtu është publikuar një përmbledhje me tri direktivat e aprovuara nga KDNM-PPP.

Në kuadër të ngritjeve të kapaciteteve njerëzore janë organizuar trajnime për NJHQ-MFK, ku janë mbajtur 9 module të Menaxhimit të Financave dhe Kontrollit. Janë certifikuar 32 Auditor të brendshëm në programin për trajnim dhe Certifikim ndërkombëtarë nga CIPFA.

Gjithashtu janë trajnuar edhe 12 tutor vendor nga CIPFA për të vazhduar programin për trajnim dhe certifikim ndërkombëtar.

Është identifikuar lista e auditorëve të brendshëm të certifikuar ndërkombëtarisht për të vazhduar në programin për arsimimin e vazhduar profesional. Lista përfshinë 32 Auditor të Brendshëm të Certifikuar.

Mbi 95% e Njësive të auditimit të brendshëm kanë përgatitur planin strategjik për auditim të brendshëm për vitin 2012-2014 dhe planin vjetor për auditim të brendshëm për vitin 2012

Po ashtu janë mbajtur trajnime në kuadër të: moduleve të shpenzimeve, Teknikat e Analizave Financiare, teknikat e investigimit financiar, gjithsej 10 analistë kanë marrë pjesë. Në fund të Shtatorit është finalizuar baza e të dhënave për NJQHAB në një platformë më të sigurt teknike (prej Excel në Access) si dhe Doracaku për Menaxhimin e të dhënave

⁴Rregulloret: Nr.11 (ART Nr.Prot.064/B/11); Nr. 09 (ART Nr. Prot. 033/B/11); Nr.08 (ART Nr. Prot. 024/B/11); Nr. 06 (ART Nr.Prot.012/B/11); Nr.3 (ART Nr.Prot.115/1/10).

Seksionin e ri të auditimit 2011 - 2012 Zyra e Auditorit të Përgjithshëm e ka filluar në shtator, dhe është planifikuar një rritje e numrit të auditimit. Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve njerëzore gjatë periudhës raportuese, 3 auditorë kanë kryer fazën e parë të certifikimit, ndërsa 1 auditor është licencuar.

3.2.8. STATISTIKAT

Gjatë periudhës raportuese në Kuvendin e Kosovës është miratuar Ligji për Statistikat Zyrtare nr. 04/L-036. Në kuadër të regjistrimit të popullsisë ka përfunduar kodifikimi i të dhënave dhe është bërë futja e tyre në databazë. Gjithashtu gjatë tremujorit raportues respektivisht TM4/2011, janë realizuar publikime të caktuara në statistikat sektoriale si dhe me theks të veçantë është bërë publikimi i BPV për vitin 2010, si dhe përmirësimi i shfrytëzimit të të dhënave administrative – bashkëpunimi ASK – ATK.

3.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA

3.3.1. VIZAT, KUFIJTË, AZILI DHE MIGRIMI

Në kuadër të kompletimit të kornizës ligjore, me 21.12.2011, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për të Huajt, Ligjin për Azilin, dhe Ligjin për Mbikëqyrjen dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror, të cilat pritet të publikohen në Gazetën Zyrtare

Ndërsa, janë miratuar katër (4) UA të Ligjit për Letërnjoftimin dhe kanë hyrë në fuqi më datën 27.10.2011. Këto përfshijnë:

UA nr. 17-2011 për përcaktimin e udhëheqjes së evidencave për letërnjoftime-dokumente udhëtimi, pasaportave;

UA nr. 19/2011 për përcaktimin e formës dhe mënyrës së punimit të letërnjoftimit;

UA nr. 20/2011 për procedurat e aplikimit për letërnjoftim;

UA nr. 23/2011 për përmbajtjen dhe përcaktimin e formës së formularëve të aplikimit për letërnjoftim.

Në projektin e digjitalizimit të regjistrave të gjendjes civile ka përfunduar pjesa e skanimit. Prej datës 01.10.2011 ka filluar përshkrimi i regjistrave. Prej datës 31.10.2011 ka filluar prodhimi i pasaportave biometrikë. Deri më datën 20.12.2011 janë lëshuar 21.995 pasaporta biometrikë.

Janë nënshkruar dy marrëveshje për ripranimin me Mbretërinë e Suedisë dhe me Republikën e Finlandës më 04.10.2011, respektivisht 29.11.2011.

3.3.1. PASTRIMI I PARAVE

Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF) ka krijuar një grup punues për plotësim-ndryshimin e ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parasë dhe Financimit të Terrorizmit, i cili është i përberë prej zyrtarëve të NjIF-it, EULEX-it, BQK-së dhe institucioneve tjera ndërkombëtare. Janë mbajtur 6 takime në periudhat tetor - dhjetor dhe i tërë materiali pritet të dorëzohet në shqyrtim në janar të vitit 2012. Ndërsa, për ngritjen e kapaciteteve institucionale, gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 4 trajnime e ku kanë marrë pjesë gjithsej 10 zyrtarë. Ndërsa në Drejtorinë për hetimin e Krimit të Organizuar është funksionalizuar njësia për hetimin e krimeve financiare të integruara e cila nga dhjetori i 2011 ka një personel prej 7 zyrtarëve policor dhe një ekspert i financave.

3.3.1. POLICIA DHE LUFTIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR

Në kuadër të luftimit dhe parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore është miratuar Strategjia dhe Plani i Veprimit për Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014. Po ashtu janë rekrutuar 24 zyrtarë policor në DHTQNJ/PK. Nga tetori deri më dhjetor 2011 janë trajnuar 30 zyrtarë policorë për hetimin dhe luftimin e trafikimit me qenie njerëzore.

Gjatë periudhës raportuese janë përgatitur tri (3) raporte për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Drogave, ndërsa raporti i katërt pritet të bëhet në fillim të janarit 2012. Sa i përket numrit të zyrtarëve policor të trajnuar në fushën e hetimit të drogave, nga 1 tetori deri më 20 dhjetor 2011 janë trajnuar gjithsej 49 zyrtarë policorë.

Gjatë muajit shtator Drejtoria Kundër Narkotikëve ka ngritur kapacitetet njerëzore edhe për 40 zyrtar policor që mbulon nevojat e kësaj drejtorie ku tani numri i zyrtarëve arrin në 85. Gjithashtu është themeluar edhe njësi për parandalim dhe bashkëpunim në kuadër të drejtorisë për hetim të narkotikëve ku përfshihet bashkëpunimi ndërinstitucional dhe është hapur linja telefonike 0800 11111 anti-drogë. Janë krijuar baza të të dhënave: për personat e varur nga drogat me qëllim që t'u asistohet institucioneve përgjegjëse për trajtim dhe rehabilitim, për personat e dyshuar duke përfshirë të gjitha të dhënat tjera dhe për rastet e drogave duke përfshirë të gjitha nivelet, prej atij lokal e deri tek niveli ndërkombëtar.

Nga tetor deri në 20.12.2011 në fushën ngritjes së kapaciteteve në luftimin e krimit të organizuar janë mbajtur trajnime ku përfitues kanë qenë 99 zyrtarë policor. Gjatë periudhës raportuese është bërë funksionalizimi i plotë i bazave të të dhënave për eksploziv dhe armë të zjarrit me ç'rast është bërë shpërndarja e skanerëve dhe fotoaparateve në të gjitha stacionet policore dhe pikat kufitare. Në aspektin e themelimit të këshillave komunal për siguri në komunitet në komunat e reja janë funksionalizuar Kllokot, Junik dhe Mamushë.

3.3.1. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Është miratuar UA për Caktimin e Zyrtarit Mbrojtës (DPO), po ashtu janë rishikuar Ligji mbi Telekomunikacionin dhe Ligji mbi Deklarimin e Pasurisë, ku janë dhënë rekomandime për amandamentimin dhe harmonizimin tyre me Ligjin 03/L-172. Për më tepër janë hartuar dhe aprovuar termat e referencës dhe përshkrimi i vendeve të punës për të gjitha linjat buxhetore të aprovuara nga Kuvendi dhe Ministria e Financave. Për më tepër Këshilli i Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 11.12.2011, themeloi një Komision i cili ka hartuar Raportin për të Gjeturat gjatë Inspektimit të Operatorëve të Telefonisë Mobile.

ANEKS I - LIGJET E MIRATUARA NGA QEVERIA DHE KUVENDI

ZYRA E KRYEMINISTRIT

LIGJET:

Ligji për Nismat Legjislative - **06.10.2011**;

Ligji për dhënien e Dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës - **21.12.2011**;

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-001 për përfitimet e ish zyrtarëve të lartë - **14.10.2011**;

Ligji i ri për Prokurim Publik, **05.10.2012**.

PROJEKTLIGJET:

Projektligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës - **23.09.2011 (Leximi i Parë)**;

Projektligji për Arkivat - **20.12.2011 (Leximi i Parë)**;

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për Lirinë fetare në Kosovë - **23.11.2011 (Miratuar në Qeveri)**;

Projektligji për Personat e Verbër dhe personat pjesërisht të verbër - **23.11.2011 (Miratuar në Qeveri)**;

Projektligji për Diasporën e Kosovës - **21.12.2011 (Miratimi në Qeveri)**.

AKTET NENLIGJORE:

RREGULLORET:

Rregullorja nr. 10/2011: "Për kontrollet Zyrtare për verifikimin e përputhshmërisë së ligjit të Ushqimit dhe Ushqimit për kafshë dhe rregullave për Shëndetin dhe Mirëqenien e kafshëve" – Rregullorja e Komisionit Evropian 882/2004;

Rregullorja nr. 11/2011 "Për Higjienën e Prodhimeve Ushqimore"; Rregullorja e Komisionit Evropian 852/2004;

Rregullorja nr. 12/2011 "Për Përcaktimin e rregullave Specifike të Higjienës së Ushqimit me Prejardhje Shtazore"; Rregullorja e Komisionit Evropian 853/2004;

Rregullorja nr. 13/2011 "Për Caktimin e rregullave Specifike për Organizimin e kontrolleve Zyrtare të Ushqimit me prejardhje Shtazore të dedikuara për konsum nga Njerëzit"; Rregullorja e Komisionit Evropian 854/2004.

MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE

LIGJET:

Projektligji për Statistikat Zyrtare të Kosovës – **15.11.2011**.

MINISTRIA E DREJTËSISË

PROJEKTLIGJET:

Projektligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve – **07.12.2011 (Leximi i Parë)**.

AKTET NENLIGJORE

UDHËZIMET ADMINISTRATIVE:

- UA për Kalimin e Kohës në Lokalet e Veçanta të Institucionit Korrektues 26.10.2011;
- UA për Pakot Higjienike dhe Pakot Ushqimore 26.10.2011;
- UA për Menaxhimin Zyrtar të Arkivit të Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) 26.10.2011;
- UA për Procedurën e Konkurrimit dhe Përzgjedhjen e Zyrave Noteriale 08.12.2011;
- UA për Numrin dhe Lokacionin e Zyrave, Lokaleve e Pajisjeve të nevojshme të Noterit 08.12.2011.

RREGULLORET:

- Rregulloren dhe Planin për Zbatimin e Ligjit për Gjykata 01.12.2011.

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL

LIGJET:

- Ligji për Bashkëpunim Ndër-komunal dhe Partneritet – **03.08.2011**.

MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

PROJEKTLIGJET:

- Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare – **07.12.2011 (Leximi i Parë)**;
- Projektligji për regjistrimin dhe evidencën e të punësuarave dhe punëkërkesve – **07.12.2011 (Leximi I Parë)**.

AKTET NËNLIGJORE:

UDHËZIMET ADMINISTRATIVE:

- UA për sistemimin e punëve të rënda dhe të rrezikshme të cilat dëmtojnë rëndë shëndetin e grave shtatzëna dhe gjdhënëse me 14.11.2011;
- UA për regjistrimin e marrëveshjeve kolektive me 30.11.2011.

MINISTRIA ETREGTISË DHE INDUSTRIË

LIGJET:

- Ligji për Tregti me Jashtë - **02.12.2011**;
- Ligji për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve – **21.12.2011**.

PROJEKTLIGJET:

- Projektligji për Lojërat e Fatit – **07.12.2011 (Leximi I Parë)**.

MINISTRIA E PUNËVETË BRENDSHME

LIGJET:

- Ligji për Mbrojtën nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera – **07.10.2011**;
- Ligji për Zjarrfikje dhe Shpëtim – **07.10.2011**;
- Ligji për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike – **15.11.2011**;
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-034 për shtetësinë e Kosovës – **15.11.2011**;
- Ligji për Agjencinë Kosovare të Forenzikës – **01.11.2011**;
- Ligji për të Huajt – **21.12.2011**;
- Ligji për Sistemin Adresave – **08.12.2011**;
- Ligji për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror – **21.12.2011**;
- Ligji për Azilin – **21.12.2011**.

PROJEKTLIGJET:

- Projektligji për Policinë – 06.10.2011 (Leximi I Parë);
- Projektligji për Zjarrfikje dhe Shpëtim – 07.10.2011.

AKTET NËNLIGJORE:

Udhëzimet Administrative

- UA për përcaktimin e udhëheqjes së evidencave për letërnjoftime/dokumente udhëtimi, pasaportave;
- UA për përcaktimin e formës dhe mënyrës së punimit të letërnjoftimit;
- UA për procedurat e aplikimit për letërnjoftim;
- UA për përmbajtjen dhe përcaktimin e formës së formularëve të aplikimit për letërnjoftim.

MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

LIGJET:

- Ligji për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e Duhanit – 15.11.2011.

PROJEKTLIGJET:

- Projektligji për shërbimet këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural – 06.10.2011 (Leximi I Parë);
- Projektligji për Bujqësi Organike – 20.12.2011 (Leximi I Parë).

AKTET NËNLIGJORE:

UDHËZIMET ADMINISTRATIVE:

- UA për kushtet dhe mënyrat e gjuetisë, datë 09.09.2011;
- UA për regjistrimin e fermerëve, datë 25.08.2011.

MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

AKTET NËNLIGJORE:

UA për licencimi dhe regjistrimi i institucioneve edukative-arsimore parashkollore private, 14.09.2011;

UA për krijimi dhe fuqizimi i ekipeve për parandalimin dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit në arsimin e obliguar, 14.09.2011;

UA për Institutin Pedagogjik i Kosovës, 14.09.2011;

UA për Kodin e Etikës për Vlerësimin e nxënësve, 23.12.2012.

MINISTRIA E FINANCAVE

LIGJET:

Ligji për Partneritetin Publiko Privat – **15.11.2011**;

Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012 – **20.12.2011**;

Ligji për Akcizën në Produktet e Duhanit – **01.11.2001**.

MINISTRIA E PUNËVETË JASHTME

LIGJET:

Ligji për Marrëveshjet Ndërkombëtare – **08.12.2011**.

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

PROJEKTLIGJET:

Projektligji për Qendre Historike të Prizrenit – 20.12.2011 (Leximi I Parë);

Projektligji për fshati Hoqën e Madhe – 31.08.2011 (Leximi I Parë);

Projektligji për Agjencinë e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore – 22.09.2011 (Leximi I Parë);

Projektligji për Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna – 20.12.2011 (Leximi I Parë);

Projektligji për Parkun Kombëtar Sharri – 20.12.2011 (Leximi I Parë)

Projektligji për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore – 21.12.2011 (Dërgimi në Kuvend).

AKTET NËNLIGJORE:

UDHËZIMET ADMINISTRATIVE:

UA për normat e lejuara të shkarkimeve në ajër nga burimet e lëvizshme.

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

LIGJET:

Ligji për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre – **07.10.2011**;

Projektligji për shërbimet e shoqërisë informatike – **14.12.2011 (Miratuar në Qeveri)**.

AKTET NËNLIGJORE:

UDHËZIMET ADMINISTRATIVE:

UA per Rregullat për Balancat e Energjisë, **15.12.2011**.

RREGULLORET:

Rregullorën për Trajtimin e Komunitetit në Sektorin Minerar – 27.10.2011;

Rregullorën për organizimin dhe funksionimin e Muzeut Shtetëror të Kristaleve dhe Mineraleve, 14.11.2011;

Rregullorën për Sigurinë Minerare, 23.11.2011.

Rregulloren për themelimin e Agjencisë së Kosovës për Efiçiençë të Energjisë, 15.12.2011.

MINISTRIA E FORCËS DHE SIGURISË SË KOSOVËS**LIGJET:**

Projektligji për Pensionet për Shërbimet në Forcën e Sigurisë së Kosovës – 07.12.2011 (Leximi I Parë);

Projektligji për dominimin humanitar – 21.12.2011 (Leximi I Parë).

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT**LIGJET:**

Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtave të Përafërta – **18.11.2011**;

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/24 për Sport – **21.12.2011**.

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS**LIGJET:**

Ligji për Hekurudhat Kosovës – 02.12.2011.

5. ANEKSI II: TABELAT

Tabela 1: Zhvillimet kryesore në sektorin e jashtëm, në miliona euro dhe si % në GDP

Përshkrimi	2008		2009		2010		2011	
	në mil. euro	në% të BPV-së	në mil. euro	në% të BPV-së	në mil. euro	në% të BPV-së	në mil. euro	në% të BPV-së
Bilanci Tregtar	-1.668	-43.3	-1,673	-42.8	-1,776	-42.4	-1,988	-42.7
Eksportet	198.5	5.2	165.3	4.2	305.0	7.3	325	7.0
Importet	-1.867	-48.5	-1,839	-47.0	-2,081	-49.7	-2,313	-49.7
Sherbimet, neto	81.1	2.1	133.4	3.4	65.6	1.6	86.3	1.9
Të hyrat neto nga investimet	168.5	4.3	90.3	2.3	89.1	2.1	107.5	2.3
Transferet, neto nga të cilat remitancat	794.4	20.6	770.2	19.7	888.9	21.2	904.1	19.4
Bilanci i llogarisë rrjedhëse	-628.0	-16.3	-679.6	-17.4	-732.0	-17.5	-890.2	-19.1
Llogaria financiare dhe kapitale	462.8	12.0	535.7	13.7	553.0	13.2	684.8	14.7
Llogaria kapitale	10.4	0.3	108.2	2.8	25.4	0.6	27.2	0.6
Llogaria financiare nga të cilat: investimet direkte	475.5	12.3	333.3	8.5	574.0	13.7	632.5	13.6
Mjetet Rezervë	-23.1	-0.6	94.3	2.4	-46.9	-1.1	25.1	0.5

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës dhe parashikimet e Departamentit të Makroekonomisë –MF

Grafiku: Ndryshimi vjetor në IÇK dhe në IÇK bazë (Core Inflation)




Tabela 2: Te hyrat dhe shpenzimet buxhetore te nivelit komunal dhe qendror Janar-Nëntor, 2011

Pranimet	Buxheti 2011 (SIMFK)	Gjithsej të Realizuara	milion euro											
			Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Të hyrat Tatimore	1059.89	961.52	74.00	61.27	68.34	87.18	83.04	88.33	102.77	107.86	92.42	106.77	89.55	91%
Tateimet Kufitare - Dogana	830.52	745.78	44.32	48.66	55.99	59.66	70.44	73.02	75.29	85.57	77.96	79.90	74.96	90%
Kthimet nga Dogana	-2.00	-0.93	-0.02	-0.12	-0.06	-0.01	-0.20	-0.05	-0.08	-0.04	-0.07	-0.12	-0.15	47%
Tatimet Vendore Administrata Tatimore	260.89	240.81	32.39	13.65	13.18	31.76	14.93	15.56	28.82	23.10	20.02	28.79	18.61	92%
Kthimet nga ATK-ja	-29.52	-24.13	-2.70	-0.92	-0.77	-4.22	-2.12	-0.20	-1.27	-0.77	-5.48	-1.80	-3.87	82%
Të Hyrat jo tatimore - niveli qendror	45.42	41.61	2.99	3.05	4.51	5.38	3.77	3.62	3.44	4.24	3.71	3.35	3.54	92%
Të Hyrat vetanake	113.60	99.26	6.25	6.88	11.64	7.39	8.64	7.90	9.41	7.30	7.77	17.51	8.56	87%
Niveli qendror	55.28	54.84	3.45	3.78	7.12	3.58	4.21	2.84	4.68	3.10	3.51	13.93	4.65	99%
Komunat	58.32	44.42	2.80	3.11	4.52	3.81	4.43	5.06	4.73	4.20	4.26	3.59	3.92	76%
Dividenda	45.00	60.00	0.00	0.00	5.00	30.00	10.00	0.00	0.00	0.00	15.00	0.00	0.00	133%
Gjithsej pranimet	1,263.90	1,162.39	83.23	71.20	89.49	129.96	105.45	99.85	115.62	119.40	118.91	127.63	101.66	92%

Pagesat	Buxheti	Gjithsej													
	2011 (SIMFK)	të Realizuara	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	
milion euro															
Paga dhe mëditja	389.38	316.67	0.00	49.17	1.17	60.26	4.67	33.45	34.16	66.29	0.52	33.25	33.74	79%	
Mallra dhe shërbime	173.52	123.50	2.98	8.20	10.21	10.84	12.71	13.81	10.47	13.98	10.74	13.30	16.24	71%	
Shpenzime komunale	22.59	16.97	0.95	1.49	1.88	2.19	1.88	1.19	1.46	1.07	1.13	1.81	1.92	75%	
Subvencione dhe transfere	272.29	231.37	11.46	19.09	21.87	17.01	19.76	30.41	22.02	26.58	17.61	24.72	20.69	85%	
Shpenzime kapitale	594.74	449.21	20.87	2.61	13.18	43.14	43.50	46.47	51.39	74.70	28.80	59.82	64.73	76%	
Rezerva	1.04	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0%	
Huaja e KEK-ut	45.00	29.09	0.00	8.99	0.44	0.33	8.64	2.53	0.54	0.00	2.61	3.42	1.59	65%	
Borxhi i jashtëm	22.30	11.45	0.00	0.00	0.57	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	10.51	0.00	0.37	51%	
Gjithsej pagesat	1,529.56	1,178.25	36.45	89.52	49.32	133.77	91.15	127.87	120.04	182.62	71.92	136.32	139.28	77%	
Bilanci i Borxhetit		-15.86	46.78	-18.31	40.17	-3.81	14.30	-28.03	-4.42	-63.22	46.99	-8.68	-37.63		

Tabela 3: Shpërndarja e FDI nëpër sektorë, si përqindje në total FDI

Përshkrimi	Shërbimet Financiare	Prodhimtari	Patundshmeri	Transport dhe Telekomunikacion	Energji Elektrike	Miniera	Ndërtim	Industri perpunuese	Bujqesia	Shërbime tregtare, pastrimi, mbledhja	Shërbime Keshillimi dhe kërkimi	Sanitari	Te tjera
2008	34.9	6.0	16.8	13.8	4.5	4.7	3.7	8.5	2.3	2.7	0.6	0.6	0.9
2009	25.5	17.11	14.9	7.4	2.9	2.4	12.0	2.4	4.4	5.5	0.9	0.8	3.8
2010 T1	16.8	18.4	19.0	10.2	0.0	1.0	17.5	10.5	1.5	2.6	1.4	0.9	0.3
T2	27.1	18.7	9.7	-0.02	0.1	0.2	15.9	11.0	0.1	5.7	4.8	1.9	4.8
T3	22.0	2.7	10.5	5.0	0.2	9.6	38.4	5.6	0.1	2.4	1.8	0.0	1.8
T4	11.8	39.3	14.3	0.8	0.2	0.3	27.8	0.3	0.8	2.5	1.3	...	0.7
2011 T1	13.9	13.7	14.0	7.0	0.4	0.0	42.1	0.3	0.1	5.6	2.5	0.0	0.1
T2	20.5	30.9	19.6	17.3	0.0	5.2	-3.8	2.3	0.5	3.1	3.4	0.0	1.2

Tabela 4: Indikatorët e sektorit bankar

Përshkrimi	Janar-Shtator 2011	
Struktura e sektorit financiar		
Bankat komerciale	77.1	-
Kompanite e sigurimit (%)	3.1	-
Institucionet mikrofinanciare (%)	3.7	-
Ndihmësit tjerë financiar (%)	0.1	-
Fondet pensionale (%)	16.0	-
Totali (%)	100.0	-
Struktura e sektorit bankar		
Numri i bankave (prej të cilave me pronësi të huaj)	8(6)	-
Share of foreign banks in banking sector (% of assets)	90.0	-
Pjesëmarrja e bankave të huaja në sektorin bankar (% e asetëve)	0.0	-
C3 (% e asetëve)	69.5	-
Indeksi Herfindahl-Hirschman	2,109.7	-
Performanca		
Kreditë me probleme (% e totalit të kredive)	6.0	-
Raporti kredi-depozita (%)	78.9	-
Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit (%)	17.1	-
Kthimi mesatar në asete (%)	1.4	-
Kthimi mesatar në kapital (%)	13.7	-
Niveli dhe kostoja e ndërmjetësimit		
Asetet e sektorit bankar (% e BPB-së)	52.0	-
Depozitat (% e BPB-së)	-	-
Kreditë sektorit privat (% e BPB-së)	34.3	-
Normat e interesit në kredi (%)	14.3	-
Normat e interesit në depozita (%)	3.5	-
Ndryshimi ndërmjet normes së intersave në kredi dhe depozita	10.8	-
Struktura e kredive e sektorit bankar		
Bujqesi (%)	3.6	-
Industri (%)	24.2	-
Shërbime (%)	72.2	-
Totali (%)	100	-

Tabela 5: Të dhënat për eksport-import

	2010		2011	
	Janar - Tetor		Janar - Tetor	
	Vlera	%	Vlera	%
Gjithsej Eksportet	244,534	100	269,478	100
Eksportet normale	103,630	42.4	118,998	44.2
Eksportet për përpunim të jashtëm	2,470	1.0	8,557	3.2
Eksportet pas përpunimit të brendshëm (S.S)	136,861	56.0	138,726	51.5
Eksportet pas përpunimit të brendshëm (D.S)	1,573	0.6	3,197	1.2
Gjithsej Importet	1,760,068	100	2,006,689	100
Importet normale	1,720,649	97.8	1,945,347	96.9
Importet pas përpunimit të jashtëm	1,918	0.1	2,403	0.1
Importet për përpunimit të brendshëm (S.S)	34,951	2.0	52,371	2.6
Importet për përpunim të brendshëm (D.S)	2,550	0.1	6,565	0.3

Tabela 6: Pjesëmarrja e FDI në GDP dhe vlera kumulative e FDI nga viti 2004

Përshkrimi	2008	2009	2010	2011
FDI si % e GDP	8.9 %	7.1%	8.5%	8.3%
Stoku i FDI nga viti 2004	1,212.3	1,485.9	1,843.9	2,228.7

